

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini


**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 226, Gusht 2022**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## KADARE: Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e MARTIN CAMAJT, ...

13

Kadare: Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e Martin Camajt, e prisja me padurim këtë takim I. K. – Kam pasur fatin ta takoj për herë të parë Martin Camajn, në tetor të vitit 1981, në Frankfurt. Pas mbarimit të një konference shtypi, m'u afrua një burrë i pashëm, i cili, pasi më foli shqip, tha emrin e vet: Martin Camaj. E njihja, pa dyshim, nëpërmjet revistës "Shejzat" të Koliqit dhe atij iu bë qejfi që ia thashë këtë. Biseduam një copë herë në këmbë, midis zhurmimit të zakonshëm të një mjedisi të tillë. Pas vendosjes sime në Paris, një mik i përbashkët gjerman, Werner Daum, që kishte qenë diplomat në Tiranë, më solli të falat e Martin Camajt, si dhe dëshirën e tij për t'u takuar përsëri, në kushte fare të tjera tani. Për fat, sapo kisha lexuar dy novelat e tij të gjata "Rrunggajat e marsit" dhe "Pishtarët e natës", të cilat më kishin pëlqyer mjaft dhe Werner Daum më tha se ishte i lumtur t'ia njoftonte këtë gjë Camajt, baslikë me kënaqësinë time për t'iu përgjigjur ftesës së tij. E lamë takimin pas disa javësh, ngaqë do të ndodhesha në Muni, ku ai banonte, në një forum ndërkombëtar shkrimtarësh. Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e tij bashkë me Daum-in. E prisja me padurim këtë takim, kur vetëm disa ditë përpara tij, erdhi lajmi i pikëllueshëm se Martin Camaj nuk ishte më i kësaj bote. Eshhtë një nga shkrimtarët më të mirë të kombit shqiptar, me po atë vlerë në prozë sikurse në poezi, dy hapësira të mëdha, me të cilat ai u përpoq të zëvendësonte atdheun e munguar. Ishte po aq i fisëm në veprën...



## TRASHËGONI TEK FËMIJËT TUJA DHE FËMIJËT E FËMIJËVE DASHAMIRËSINË HISTORIKE TË VENDEVE TONA!

**Kumtesë e mbajtur në "Forumi i Mesdheut Montecatini (Toskana)", Shqipëria dhe Mali i Zi**

Të nderuar miq!

I nderuari Senator miku ynë i çmuar, z. Manuel Viskovi, President i Shoqatës së miqësisë Itali Shqipëri! Përsëndetje vëllezër të shoqatës atdhetare "Bashkësia shqiptare"! Përsëndetje më të mira organizatoreve dhe faleminderit për ftesën!

Mirë se u gjetëm!

Të miqësuar, të mirë vlerësuar dhe të gëzuar qofshi për të gjatë e mot!

Kultura është vegimi qiellore, që na transformoi në qenie humane superiore. Veprimtaria e jonë e gjithë pushtetshëm fillimisht ndërtoi djepin tonë Ne, si fëmijët e natyrës na përzgjodhi të jemi fqinjë ballë për ballë dy brigjeve, të përfaquar prej flladëve, bujare, por edhe të trazuar prej baticave dhe zbaticeve këtij ujëmadhi tekanjor.

Fatlum apo të dënuar mbijetuam mijëra vjet mes amplitudave barike, duke shkruar mirë e pse jo edhe me gabime historinë, por jo kulturën dritë-amshuar të gjeneratave tona të lashta e të reja sa vetë historia.

## FORUMI I MESDHEUT MONTECATINI (TOSKANA), SHQIPËRIA DHE MALI I ZI

Forumi i Mesdheut Montecatini (Toskana), Shqipëria dhe Mali i Zi u zhvillua në qendrën Kulturore 800 vjeçare Montecatini në Itali

Në forum ishin të ftuar shoqata kulturore "Bashkësia Shqiptare" në Toskanë, Shoqata Kulturore "Besa-Shoshi". Forumi përvijoj e me larmi të veprimtarish të ndryshme nga ora 15.00 deri në orën

23.00, me konferenca shkencore me ekspozita të arti, panairë të produkteve industriale balet, muzike lojëra aerobike, debat i hapur politik, shpalosja e programit alternativ politik, ku në qendër të vëmendjes ishte roli i bashkësisë shqiptare, i Rajonit të Toskanës në jetën politike dhe shoqërore të këtij vendi.

Në Rajonin e Toskanës banojnë 60 280 shqiptare, në Pistoja 12 mijë, në Firenze me 9 mijë e Bratoja dhe kështu me radhe, nga të cilët 24 mijë janë pajisur me pasaporta italiane



# TRASHËGONI TEK FËMIJËT TUJA DHE FËMIJËT E FËMIJËVE DASHAMIRËSINË HISTORIKE TË VENDEVE TONA!

Kumtesë e mbajtur në “Forumi i Mesdheut Montecatin i (Toskana)”, Shqipëria dhe Mali i Zi

Të nderuar miq!

I nderuari Senator miku ynë i çmuar, z. Manuel Viskovi, President i Shoqatës së miqësisë Itali Shqipëri!

Përhëndetje vëllezër të shoqatës atdhetare “Bashkësia shqiptare”!

Përhëndetjet më të mira organizatorëve dhe faleminderit për ftesën!

Mirë se u gjetëm!

Të miqësuar, të mirë vlerësuar dhe të gëzuar qofshi për të gjatë e mot!

Kultura është vegimi qiellore, që na transformoi në qenie humane superiore.

Veprimtaria e jonë e gjithë pushtetshëm fillimisht ndërtoi djepin tonë

Ne, si fëmijët e natyrës na përzgjedhi të jemi fqinjë ballë për ballë dy brigjeve, të përqaftuar prej flladeve, bujare, por edhe të trazuar prej baticave dhe zaticave këtij ujëmadhi tekanjor. Fatlum apo të dënuar mbijetuan mijëra vjet mes amplitudave barike, duke shkruar mirë e pse jo edhe me gabime historinë, por jo kulturën dritë-amshuar të gjeneratave tona të lashta e të reja sa vetë historia.

Për miliona e miliona sy e shpirtra delikat Toskana është një Venerë hirpote me peizazhet të mahnitshme, është antika me histori të pa shoqe veshur me fustanin e artë të trashëgimisë kulturore të gjithëkohësisë

Toskana është vetë Minerva hyjnore, që lindi dhe ushqeu me gjirinin e saj të bekuar Rilindjen italiane, Toskana është gurra ushqyes e penave të magjishme të Dantes, Petrarkas, Bokaçios Makiavelit e të tjera.

Ashtu si për ne shqiptaret, Shkodra mbetet kryeqyteti shpirtërorë i kulturës sonë dhe Toskana mbetet shtëpia e shumë figurave me ndikim në historinë e artit dhe shkencës me përmasa Evropiane, ku ndonjëherë edhe konsiderohet “një komb brenda një kombit”.

Ndonëse të ndarë nga shpesh prej Himalajesh të acarta, kemi adhuroar si hënën kulturën dritëdhënëse, italiane, muzikën, baletin që ja falët botës, por ndoshta edhe më tepër vlerat e pa shoqet, gastronominë mbretërore, gratë dehëse, dhe futbollin triumfues axur.

Bash këtu në Toskanën e sotme në veri të Lacin qe Etruria e moçme e themeluar nga mërgimtarët etrusket-ilir. Ata zbarkuan këtu ndoshta, pare se të lindte Roma dhe nga egjiptianet thirreshin trasha, ndërsa grekët i quanin etrusk. Babai i historisë Herodoti qartësisht i ka nënvizuar se etrusket ishin ilir.

Albanologu frëng Zaharia Majani, specialist në fushën etruskologjisë, në vitin 1961 botoi libri “Etrusket filluan të falsin”; ndërsa me 1968 nxori librin tjetër “Fundit i misterit etrusk”, duke argumentuar origjinën, gjuhën dhe jetën etruskëve sipas teksteve të deshifruara nga ai. Roma e ylbërtë kishte edhe të purpurtën etruske, e cila i dha gaz motorëve të ndezur romak në fushatën ngjitëse mbi italikët. Zonjës me

shkëlqim qiellorë Etrusket i dhanë artin e portretit, lojën e gladiatorëve të arenës, shenjat e pushtetit, togën dhe stemën e mbretit. Më në fund etrusket falën dhe vetën e tyre duke u bërë pjesë e luaneshës romane kozmopolite. Edhe mes ferrit historikë shqiptarët e kanë lexuar e mësuar Ferrin të Dantës e Librin e Këngëve



të Petrarkes. Për kujtesë po ju themi edhe ne kemi një poet Kombëtarë, po aq të adhuroar për shqiptarët sa Dante për ju. Gjergj Fishta ynë ishte edhe akademik i Italisë. Nder shkolla kemi mësuar me endje madhështinë galaktike të Romes, jemi mahnitur nga peneli Mikelanxholos, Refaelit, Davinxhit. BUÇINIT, për të vijuar me Françesko GRANACCI, Sandro Botiçeli, Bartoleme Pineli, Viktor Karpoçi. Kemi duartrokatur e adhuroar apostuj e pentagramit Vivaldin, Paganinin, Puçinin, VERDIN. E kush nuk i njih dhe nuk i do tenorët ENRIKO Caruso, Andrea Bocelli, Giuseppe Di Stefano dhe ndëryjorin Luçian Pavaroti. E kemi simpatizuar vargmalet e letërsisë italiane duke filluar me Xhordano Brunon, Dino Buzati Aleksander Manxoni. Luigji Ugolini, ALBERTO MORAVIA, Pjer Paolo Psolini, Bruno VESPA, Grasia Delada, Umberto Eko, Fabio Volo e të tjerë e të tjerë. Por edhe ne kemi penat tona që shkëlqyen në tokën tuaj si Derada, Serembe, Matrenga deri tek kalorësit e prozës moderne Koliqi e Camaj pa harruar fenomenin Kadare, Agollin, Migjenin apo Naimin e Çajupin.

Këto veprimtari nder kulturore shkop-sitin paragjykimet e ushqyera nga mendim i gabuar i pambështetur, i ngulitur nga njohja jo e plotë e historisë dhe dukurive të botës shqiptare dhe e shkaqeve të tyre.

Të ritë tanë, duke u rritur shkolluar punuar e jetuar së bashku me të rinjtë tuaj, duhet të njohin reciprokisht historitë dhe traditat e dy anshme.

Kur zonja Evrope nuk ekzistonte ne ishim këtu, në bregun lindor të deteve ilirike. Sot Evropa politike na sheh me paragjykim si popull me aftësi të kufizuara shtet formuese dhe harrojnë se ne kishim jo vetëm dinasti mbretërore, por edhe mbretëreshë që në vitin 227 P K, kur ende edhe në Romën shkëlqimtare një gjë e tillë ishte herezi gjinore.

Romës luaneshës e plot fuqishme e botes antike i dhamë një togë perandorësh ilir dhe me gjak ilir. Lista është e gjatë, por jashtë modestisë dua të citoj vetëm tre emra pa të cilët historia e Romes do ishte me një godinë madhështore pa çati. Dardani Diokleciani, i quajtur “Burri i shekullit të artë, dëshmitari suprem i madhësisë, njëri ndër tre perandorët që historia romake admiron më tepër.

Konstandini i Madh, themelues i Kostandinopojës, Perandori i parë i krishterë, që ndryshoi historinë.

I famshmi Justiniani, ligjvënësi, reformat e tij juridike, kodi që mban emrin e tij, është ende sot në themel të së drejtës private të Evropës.

Shqipëria është përcaktuar si një nga vendet mesdhetare, ku krishterimi depërtoi qysh në shekujt e parë, prandaj edhe Lidhjet mes brigjeve tona fituan dimension tjetër shpirtërore Shtatë papë iliro – shqiptarë i dhamë Selisë së Shenjtë, që u **shqua mbi të gjithë Papa Klementi XI ose Gjon Francesk Albani - Laçi**

Uragani osman rrezoi Perandorinë shkëlqimtare Bizantine dhe ndryshoi historinë e botës.

Një perëndim endemik laraman pa shtyllë kurrizore tej i brishte lëkundej si varkë pa timon mes valësh të acarta. Në situatën me kritike qysh në lindje të zonjës së vjetër ju gjend në krah përfaqësuesi më i përkryer i më të lashtës racë në Ballkan, krye heroit ynë dhe heroit i Evropës Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Mos harroni të nderuar miq kur ushtrat e Mehmet Fatiut Pushtuesit përpara Krujës thërrisnin Roma, Roma, ato u zbrapsën nga ky kapedan i madh i një populli të vogël. Me vdekjen së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut toka fatlume, që lindi u vesh në zi dhe vajtoi më të madhin fatos, që lindi dhe më të madhin gjeneral që rriti. Pas qëndresës dhëmbë shtërënguar 10 vjeçare të Lekë Dukagjinit fortesat Krujës, Drishtit dhe Shkodrës ranë nënë zgjedhën osmane dhe gjithë popullata u fut nënë shtatë. Errësira ra

plumb ra mbi tokën iliro- arbërore dhe mërziqshëm filloj një nga tragjeditë më regresive në historinë tonë të shumë vuajtur. Shqiptarët nuk mund të harrojmë kurrë, humanizmin Republikës Veneciane, që evakuoi dhe mori në mbrojtje mijëra gra, fëmijë, pleq e të rijë, duke i shpëtuar nga shfarosja masive.

Çdo e keq ka dhe një të mirë këtu, në tokën tuaj gjetën strehe bujare, valë pas vale emigratorë arbëreshe. Këtu gjetën atdheun e dytë, këtu ndërjuan urën e pa thyeshme miqësisë italo-shqiptare.

Arbëria jonë kufij mes fushave barike te dy cikloneve ndërkontinentale, u rrafshua, e mbeti pa fortesa, pa qytete, pa universitete e tempuj shekullarisht i ndaluar të shkruante dhe lexonte gjuhen e vet.

Me tepër nga zori se nga leverdia shumica e shqiptarëve u konvertuan në fenë e re islame, por kurrë feja nuk dominoj mbi gjakun tonë. Kurrë shqiptaret nuk zhvilluan luftëra fetare as nuk u vranë për fe mes veti.

Bashkëjetesa jonë fetare është mrekulli shqiptare, që nuk ekziston askund tjetër kaq mirësisht.

Edhe në ditë më zeza të herezisë osmane- komuniste, Italia për Shqipërinë ka qenë porta dhe dritarja e hapur për Evropën e ndaluar.

Ne mbi jetuam në saje të genit qëndresëtare gjuhës së veçantë dhe të drejtës tradicionale Lekjane nga më autentiket dhe njerëzore të kohës së vet.

Ne adhurojmë dhe e njohim mirë Garibaldin, heroin e bashkimit tuaj kombëtare, ai ishte trim dhe strateg i një kauze të madhe historike, prandaj e mbështeten arbëreshët tanë dhe tuaj. Madje Luigj Gjuraj ishte Ministër i Punëve Botore, në qeverinë e tij. Ne i jemi mirënjohje për pjekjeve maksimalisht të Italisë për pavarësimin e Shqipërisë.

Fatkeqësisht as sot padrejtësitë historike tona nuk janë zgjidhur plotësisht, ndërkohë që ka tridhjetë vjet që na lënë pas dere si fëmijë lypsarë të pa dëshiruar.

Dera e hapur dhe bujaria e madhe italiane qoftë në eksodet e viteve 90-të, qoftë në trazirat tona të çmendura të vitit 1997 janë përjetësisht të arkivuar në shpirtat e shqiptarëve liridashës. Bujaria juaj ka marrë uratën edhe bekimin e shenjtore dhe nënës universale të mirësisë motrës tonë Nënë Tereza.

Miq të Shoqatës së Miqësisë Itali - Shqipëri edhe ju vëllezër të shoqatës atdhetare “Bashkësia shqiptare”, trashëgoni tek fëmijët tuja dhe fëmijët e fëmijëve dashamirësinë historike të vendeve tona.

Ne duam një Itali me rol parësorë në Evropë!

Evropa për ne është ëndërr sublime!

Rruga jonë për atje kalon përmes kumbareshës së vjetër Itali!

**Prele Milani,**  
**Toskanë, me 25 qershor 2022**

# FORUMI I MESDHEUT MONTECATINI (TOSKANA), SHQIPËRIA DHE MALI I ZI

Forumi i Mesdheut Montecatini (Toskana), Shqipëria dhe Mali i Zi u zhvillua në qendrën Kulturore 800 vjeçare Montecatini në Itali

Në forum ishin të ftuar shoqata kulturore "Bashkësia Shqiptare" në Toskanë, Shoqata Kulturore "Besa-Shoshi". Forumi përvijoj e me larmi të veprimtarish të ndryshme nga ora 15.00 deri në orën 23.00, me konferenca shkencore me ekspozita te arti, panire te produkteve industriale balet, muzike lojëra aerobike, debat i hapur politik, shpalesja e programit alternativ politik, ku në qendër të vëmendjes ishte roli i bashkësisë shqiptare, i Rajonit të Toskanës në jetën politike dhe shoqërore të këtij vendi.

Në Rajonin e Toskanës banojnë 60 280 shqiptare, në Pistoja 12 mijë, në Firence me 9 mijë e Bratoja dhe kështu me radhe, nga të cilët 24 mijë janë pajisur me pasaporta italiane

Për here të parë shqiptarët arritën të përfaqësohen në Këshillat Rajonale në tre komuna me këshilltarë. Bruno Leka nga Shkodra është njeri prej këtyre këshilltarëve në Komunën e Koradave. Në këtë bashkësi tashme të mirë integruar kanë përfunduar studimet e lara mbi 1500 të ri e të reja, të cilët punojnë në vende të rëndësishme në administratën shqiptare.

Në forumin e Mesdheut ishin të pranishëm Presidenti i Rajonit të Toskanës i shoqëruar nga tre senator italian.

Presidenti i Shoqatës së miqësisë Itali-Shqipëri, zoti Manuel Viskovi paraqiti platformën dhe alternativat, programin politik bashkëpunues të rajonit të Mesdheut (Itali-Shqipëri-Mali zi), e cila ishte platforme politike e programit të tij elektoral

Përsëritetën ambasadorja e Malit të Zi, znj. Sofranca Ljubjeviç dhe Ambasadorja shqiptare, znj. Anila Brutani Lani. Diskutuan shumë personalitete të jetës publike të fushave të ndryshme, si Simone, Minicucci Frabrizio Mafredini, Luca Baroncini; znj. Monika MICELI Panazzo

U përmend Shkodra, si dritare e hapur pro italiane - perëndimore, u foli për projekte konkrete. Aty kishte një vend bosh edhe për Kryetarin e Bashkisë Shkodër, por nuk pati as kryetare as zëvendës dhe as një përfaqësues.

Në forum publicisti dhe prozatori Prele Milani mbajti kumtesën, me temë "Trashëgoni tek fëmijët tuja dhe fëmijët e fëmijëve dashamirësinë historike të vendeve tona!"

Një pjese e programit në forumin e Mesdheut ishte rezervuar edhe për Grupin "Besa Shoshi", i cili me kostume tradicionale dukagjinase u paraqit denjësisht përpara një publiku të përzgjedhur nga kultura dhe bashkësi shumë ngjyrëshe.

I dhanë hijeshi dhe vegim bukurie shqiptare vajzat tona Diana Fusha, Ardiana Kosteri dhe Danjela Lokthi, të cilat u daluan jo vetëm si kërcimtare e një vallje

me motive nga vendlindja. Danjela Lokthi si prezantuese e bën publikun për vete, me zërin e saj të ëmbël dhe elokuent, që nder të tjera tha:

Të nderuar pjesëmarrës, miq e të ftuar, artist të këtij mozaiku ndër kulturorë italo-shqiptare!

I nderuari mik i syzuar i Shqipërisë dhe shqiptarëve Senator dhe President i Shoqatës së miqësisë Itali-Shqipëri z. Manuel Viskovi!

E nderuar mike e madhe e bashkësisë shqiptarë në Toskanë, znj. Monika MICELI Panazzo!

Të dashur vëllezër të shoqatës atdhetare "Bashkësia shqiptare"!

I nderuar zoti Kryetar Gjergj Temeli, faleminderit për ftesën dhe mirë se u gjetëm!

Shoqëria Kulturore Artistike "Besa Shosh" ndihet e vlerësuar, e obliguar dhe e emocionuar, që gjendet në mesin tuaj

Erdhëm këtu në Toskanën e begatë, shtëpinë e ëndrrave tona të ndaluara.

Erdhëm këtu në shtëpinë e madhe të kulturës italiane dhe djepin e rilindjes evropiane.

Mes dy brigjeve tona gjendet një det i gjerë, mbi të cilën popujt tanë edhe mes shtrëngatave më të ashpra kanë ngritur ura komunikimi, bashkëpunimi dhe miqësie historike të kthyer në traditë. Vijnë nga toka e shqipeve Arbënore, e Gjergj Kastriotit -Skënderbeut, ora fatlume popullit shqiptarë, por edhe mburojë e civilizimit perëndimor!

Vijnë nga dera e të lumes Nënë Tereza, simbol i sakrificës, thjeshtësisë, dashurisë dhe mirësisë.

Vijnë nga fortesa Iliriane e Agronit dhe Teutës, për të sjellë përpara jush pak aromë Shkodre, një valle të lumnueshme Dukagjini të stolitur me xhubletën 4000 vjeçare shqiptare.

Vijnë modestish, me një hark lahute, që për sjellë jehonën e eposit të shqipeve.

Vijnë të veshur nostalgjisht me xhamadana, tirq e kapuçë, si dikur Shoshi, fisnik e krenar.



Le ta fillojmë paraqitjen tonë me një motiv të vjetër bjeshkatore "Vallja e Mrizit".

-Lahuta është korda dhe kolona tingullore marsheve epike shekullore ilirishqiptar "Nënë Shqipëri", që e këndon lahutari Gjon Kosteri.

Historianet botërore e krahasuan nder më të përndriturin gjeneral të luftërave mbrojtëse të kohëve.

Gjergj Kastrioti është përfaqësuesi ma me zë i racës sonë më vjetër në Ballkan "Skënderbe Zot i Arbrit", që e këndon Grupi i burrave "Besa-Shoshi".

Në përfundim të koncertit, në të cilin u përformuan artist dhe rryma të ndryshme muzikore, si grupi "Besa-Shoshi" meritohet çmimin e parë, të cilin ja dorëzoi znj. Monika MICELI Panazzo.

Me date 26 qershor 2022, Grupi "Besa-Shoshi" u gjend në një nate të pa harruar, pa protokoll, pa zhurme shurd-

huese, pa truke komerciale mes vëllezërve të Palajve të Shoshit. Dashamirësi, mall respekt, bujari, gaz, humor nostalgji të vjetra e njohje të reja. U befasuam nga respekti i dhjetëra të rinjve të pashëm, të thjeshtë e gjithë edukate e mirësjellje vinin dhe na prezantoheshin: Jam djali, vajza apo nipi i ....

Na gëzoi pa mase se, me sa dashuri e pasion i këndonin këngët e vendlindjes së tyre. U gëzuam se sa mirë ishin integruar, duke arritur një stad kulture e jetese, që kurrë nuk do ua dhuronte vendlindja e mbetur shkrete dhe rrënuar nga duhitë e motit të çmendur.

Mos të çohemi, pse po na ikë rinia, pasi me duart tona ua kemi prishur bunin e një jete njerëzore.

Gjon Kosteri

# Logu i Bjeshkëve të Kelmendit-2022



**Dila Bujaj**  
**Mis Bjeshka 2022**



**Melisa Durgaj**  
**Vëndi i II në Mis Bjeshka 2022**



**Dorina Keqaj**  
**Vëndi i III në Mis Bjeshka 2022**

Tashmë është bërë traditë, që sezoni veror ti bashkojë shqiptarët në tokën amë, jo vetëm për t'u çmallur me njëri – tjetrin, por edhe për t'u çlodhur nga stresi i punëve dhe jetës rutinë në vendet ku kanë emigruar dhe janë integruar. Kthimi i tyre në vendlindje u jep energji dhe forcë, nga e cila mbajnë të gjallë atë shqiptarizmin e tyre pasi, jo pak nga ata i merr malli të dëgjojnë e të flasin shqip. Edhe pse qëndrimi i tyre është i shkurtër dy ose tre javorë, kohën e tyre përpiqen ta shfrytëzojnë sa më mirë duke u bashkuar me njëri – tjetrin në festa e gëzime sikurse është edhe “Logu i Bjeshkëve” të Kelmendit, një festë e përvjetshme, për të cilën emigrantët kanë shfaqur vazhdimisht interes. Pas eksperiencës së dy viteve më parë, e cila la jo pak pasoja në jetën sociale të secilit prej nesh, pandemia rëndoi ca më shumë tek emigrantët, të cilët veç vështirësive ekonomike patën probleme edhe me rinovimin e dokumentacioneve, çka bëri që shumë prej tyre që prej 2019 të mos mund të kthehen në vendlindje vetëm këtë verë. Fluksi i tyre u vu re jo vetëm në trafikun e rënduar në hyrje daljet e qyteteve, por edhe në dasma e shumta në festat familjare e sidomos në “Logun e Bjeshkëve”, në të cilin si rrallë herë bujtinat dhe lokalet e shumta të kudogjendura përgjatë rrugës Tamarë - Vermosh nuk kanë mundur ti përballojnë fluksin e të ardhurve, për ato dy ditë Logu. Shumë prej tyre të vetëdijshëm për situatën kishin përgatitur ushqim dhe pije për të shtruar piknik nën hijet e mrizeve dhe aheve pranë burimeve të ujit në kodrat dhe livadhet përreth Qafës së Predeleci. Mos përcaktimi i një date fikse nga organizatorët e këtij manifestimi kulturor bëri që këtë vit numri i konkurrenteve pjesëmarrëse të bjeri në njëmbëdhjetë ku pesë prej tyre ishin me origjinë nga Kelmendi dhe secila prej tyre kishte të përbashkët “godin” e malësore nën petkun e xhubletës.

-Kristina Ulaj, me origjinë nga Boga, studente e mjekësisë, në degën laborante

dentare, e lindur dhe rritur në Shëngjin.

-Anisa Struga, me origjinë nga fshati Nikç, e lindur dhe rritur në Laç e lidhur me botën e televizionit.

-Elsida Bunjaj, me origjinë nga Tamarja e pasionuar pas natyrës madhështore

imin e resurseve që ofron vendlindja e saj.

-Dorina Keqaj, sapo ka mbaruar gjimnazin “Dodë Kaçaj” Bajzë, e pasionuar mbas traditave çka e bën të jetë aktive në veprimtaritë, në të cilat tradita malësore është kryefjalë e saj.

Hoti i Malësisë së Madhe e pasionuar pas këngës, e cila vazhdon studimet e larta në degën e kantos.

-Dila Bunjaj, me origjinë nga Vermoshi, lindur dhe rritur në Amerike e lidhur fort pas vendlindjes së saj në gen e



të Bjeshkëve të Kelmendit, për të cilat demonstroi krenari për to.

-Sandra Pepaj, me origjinë nga Tamarja e pasionuar mbas traditave të lashta të vendit të saj e në veçanti xhubletës e vesh dhe për formon sa herë bëhen organizime festive në Kelmend.

-Dejana Hasaj, me origjinë nga Flaka e Malësisë së Madhe e diplomuar për ekonomi - turizëm e pasionuar pas bukurisë së alpeve dhe turizmit malor, po jep një kontribut të jashtëzakonshëm në promov-

-Melisa Durgaj, me origjinë nga Shkrelli me shpirt artisteje, së cilës i pëlqen poezia, kërcimi dhe kënga popullore e bënë të veçantë pjesëmarrjen e saj në këtë Log.

-Arjola Stafaj, e vetmja konkurrente, e cila hyri në garë si mbese e Bjeshkëve të Kelmendit, krenare për këto vise ku ruhen traditat e gjyshërve të saj.

-Jozefina Camaj, me origjinë nga Hoti nën Malin e Zi, përfaqësuese e bukurisë së vajzave malësore të Malit të Zi.

-Sarabela Hasanaj, me origjinë nga

me shpirt, pasioni e solli të bëhet pjesë e kësaj tradite, për të cilën kishte dëgjuar nga familjarët e saj.

Secila nga vajzat konkurrente shpalosi krenarinë dhe dinjitetin e malësore me veshjen origjinale të xhubletës, duke ruajtur edhe kriterin me të cilin merr kuptim kjo veprimtari apo ngjarje kulturore. Folklori dhe kostumografia e Malësisë së Madhe ishin të pasqyruara me kujdes, duke i përshtatur për rastin si alternativa kryesore ku turizmi kulturor i kësaj treve

prek majat e suksesit. E kthyer në traditë nga organizatorët pati tre çmime për performancë dhe një çmim nga mundësorët financiar. Vajzat fituese të gjykuara edhe nga "Jurja" veç hijeshisë janë vlerësuar edhe për civi-në e tyre vetjake, të cilat edhe pse në moshë të re premtajn shumë për një të ardhme të suksesshme.

-Fituese e çmimit të tretë në "Logun e Bjeshkëve të Kelmendit 2022" ishte Dorina Keqaj, konkurrentja me numër 6.

Vajza shtatnaltë e ardhur nga Ivanajt e Bajzës, përfaqësuesja e vetme e Malit të Kastratit, e cila ndër të gjitha konkurrentet pjesëmarrëse, gëzonte cilësi të veçanta të nuses malësore nën petkun e xhubletës e bën vlerësimin e saj më se të merituar.

E lindur në një familje të thjeshtë, me të ardhura modeste, trangu i së cilës ka nxjerrë burra me zë e gra të fisshme, arriti të marrë një vlerësim unanimit nga "JURIA", për këtë çmim, gjë që (ndoshta jo e qëllimshme) goditi në shenjë për të thyer tabunë e krijuar në opinionin publik, se çmimet janë vlerësime me paradhënie. Xhubleta me të cilën konkurroi Dorina Keqaj në Logun e Bjeshkëve 2022 u mundësua nga Shoqata Kulturorë "Xhubleta e Alpeve Shqiptare", veshtarja e së cilës ishte znj. Katerina Rakaj.

-Fituese e çmimit të dytë në "Logun e Bjeshkëve të Kelmendit 2022" ishte Melisa Durgaj, vajza me numër 7 nga Ducajt e Shkrelit, lindur e rritur në Koplik. Melisa Durgaj, një vajzë me formim të jashtëzakonshëm, e mirë edukuar nga dy prindër punëtor e të përkushtuar, Prelë e Kristina Durgaj dita ditës po tregojnë se premtajn për t'u bërë një njeri dinjitoz me një karrierë të suksesshme. Hobi i saj për fotografi, interpretim, oratori, dije dhe këngë e bëjnë këtë vajzë një krenari për Malin e Shkrelit, njëkohësisht dhe për qytetin e Koplikut. Fisnikëria dhe hijeshia e saj nën petkun e xhubletës u vlerësua nga "JURIA" me çmimin e dytë, një vlerësim mjaft i merituar. Ajo që e bën ende më të veçantë ndër konkurrentet e tjera ishte petku i saj, i xhubletës e trashëguar nga Gjyshja Diella, e cila e ka punuar në rininë e saj me duart e veta. Kjo pasuri familjare e bën akoma më të vlerësuar jo vetëm si konkurrente në "Logun e Bjeshkëve 2022", por edhe për etnokulturën e Malësisë së Madhe. Një kriter që vlen të theksohet, pse jo edhe të merret për bazë në vlerësimin pasi vetë "Logu", kryefjalë të tij ka trashëgiminë kulturore e në veçanti xhubletën. Urime të sinqerta mori Melisa Durgaj bashkë me urimet për znj. Diella e Flora Durgaj, artizanet e gjalla dhe vesharet e rralla të petkut të xhubletës.

-Mes brohoritjeve të shumta dhe emocioneve të munguara prej kohësh në "Logun e Bjeshkëve të Kelmendit" u mirëprit edhe shpallja e çmimit të parë nga përfaqësuesi i "Jurisë", kelmendasi Mark Babani, i cili gjithë tonacion krenarie, shpalli emrin e vajzës Dila Bujaj. Një emocion i bukur e ringjalli dhe njëherë atë peshën e nderit dhe vlerësimit të rëndësishëm dhe kuptimit, që mbart ky "Log" për Kelmendin dhe kelmendasit, aq sa thënie e çmuar e kuptim plotë të popullit tonë se: "GURI RANDË PESHON N'VEND T'VET", e vërtetoi edhe njëherë vajza nga Vermoshi i Kelmendit, konkurrentja me numër 11, DILA BUJAJ. E lindur dhe rritur në New York, metropo-

lin më të madh të botës së qytetëruar, në një familje të kulluar malësore, Dila Bujaj njihet si një vajzë e mirë edukuar dhe mirë shkolluar nga prindërit e saj Gjovalin dhe Prena Bujaj. Si shumë bashkë-

rorën "LOGUT" si, konkurrentja më e "PASHME" në "Logun e Bjeshkëve të Kelmendit 2022". Duke i uruar suksese të përzemërta kësaj "ZANË" shtegtare, por bjeshkatere, gjej rastin të përgëzoj edhe

të trashëguar në shekuj. Edhe këtë vit "Logu i Bjeshkëve të Kelmendit" u organizua nga Bashkia Malësi e Madhe nën mbikëqyrjen e posaçme të Kryetarit të Bashkisë, z. Tonin Marinaj, i cili në



moshatarë të saj emigrantë, Dila Bujaj u rrit me krenarinë e të qenit shqiptare e diçka më shumë "Kelmendase", çka bëri që vajza kelmendase me një guxim shqiponje të shtegtojë nga Amerika e largët enkas për t'u bërë pjesë e këtij konkursi dhe njëkohësisht t'i tregojë botës se,

veshtaren Mri Lumaj, për godin e vajzës dhe xhubletën e saj, me të cilën konkurroi MIS BJESHKA 2022, Dila Bujaj.

Ndërsa çmimin e sponsorit nga "Qendra Afrodit" e mori konkurrentja me numër 2, Anisa Struga, vajza nga Laçi, me origjinë nga Tamarja. Ky çmim u dha

mbyllje të këtij spektakli pasi falënderoi pjesëmarrësit nuk nguroi të flasë me nota kritike për shtimin e numrit të konkurrenteve pasi Malësisë së Madhe, nuk i mungon shpirti i garës dhe as burimet njerëzore me të cilat krenohemi të gjithë.

Kjo veprimtari kapi majat e suksesit



Kelmendi përkund djepa e rritë bij e bija që e duan, e çmojnë, e vlerësojnë, e mbrojnë dhe e nderojnë "si dikur motit edhe në ditët sodit", në treveza, në kuvende, në logje e në sfida, duke e mbajtur të gjallë krenarinë që u mishëruan Alpet mbi krye këtyre malësorëve. Guximi dhe sakrificat e saj bëri krenarë jo vetëm prindërit e saj, por edhe Vermoshin e krejt Kelmendin. Me hijeshinë e saj gjenetike të trashëguar nga geni familjar, nën petkun mbretëror të xhubletës, Dila Bujaj rrembeu ku-

nga kjo qendër, që i mundëson vajzës një kurs profesional estetikë - parukeri falas.

Logu i Bjeshkëve të Kelmendit edhe pse organizimi i tij me varësi institucionale, bëri serish bashkë bjeshkatëret e Kelmendit, të cilët kishin ardhur nga Amerika e largët enkas për këtë manifest kulturor. Shumë prej tyre të veshur me veshje tradicionale u mikpritjen, kënduan e gëzuan me miqtë e ardhur nga të katër anët e trojeve etnike çka nënkupton bujarinë e pashoqe të këtyre malësorëve

falë moderatorit të talentuar, malësorit Bes Jaçaj, i cili e menaxhoi me shumë profesionalizëm të gjithë "Logun e Bjeshkëve të Kelmendit 2022", duke dhuruar për publikun një spektakël të vërtetë.

Këtë veprimtari e pasqyruan të gjitha mediat lokale e kombëtare edhe pse ekskluzivitetin e kishte studio "Jeta Shkollore".

**Përgatitur nga Rita Shkurtaç, Gusht 2022**

# ULQINI PRET BIJTË E VET

Festë madhështore në speltaklin “Diaspora në vendlindje”

Shqiptarët e Ulqinit që prej vitesh kanë marrë rrugën e mërgimit e që prej vitesh kanë ndërtuar jeten e tyre anë e mbanë Botës, por kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë krijuar edhe komunitetin e tyre që tashmë i kalojnë dy breza.

Ky komunitet ndihet krenar që i ka realizuar një bote të re, një jete të re, duke ruajtur të gjitha vlerat e origjinës: gjuhen, traditën, zakonet.

Kjo festë e kthyer në traditë, bën që ata të ndajnë me njëri-tjetrin gjithçka të bukur të përjetuar gjatë gjithë vitit në jetën e tyre larg vendlindjes. Kjo festë e promovuar pesë vite më parë, synon t'i mbajë të bashkuar edhe më shumë shqiptarët e Ulqinit e jo vetëm, kudo janë.

Ana e Malit është një nocion gjeografik me shumë vlera e histori, që fillon që në burimin e Lumit Buna, e përfundon në perlen e Adriatikut, Ulqinin e bukur e të lashtë.

Ky qytet i bukur dhe i lashtë padrejtësisht u shkëput nga trualli i të parëve, por banorët e tij dhe gjithë anamalësit asnjëherë nuk u shkombtarizuan, asnjëherë nuk harruan gjuhen e të parëve, këngën e të parëve, traditën e të parëve.

Ky është lajtmotivi i gjithë atyre që për arsye historiko-ekonomike, rreth 100 vjet më parë kanë zënë vend dhe jetojnë në vendet e ndryshme të Evropës, por kryesisht në tokën amerikane.

Ky është lajtmotivi që ulqinakun, veprimtarin atdhetar, Naser Nika e frymëzon që prej 5 vitesh për të organizuar këtë festë madhështore, ku pjesëmarrës janë të gjithë mërgimtarët e kësaj krahine.

Në këtë festë morën pjesë edhe drejtues të Komunës së Ulqinit, por dhe përfaqësues të qeverisë të Malit të Zi, të cilët përgëzuan organizatorin e mirënjohur Naser Nika për iniciativën dhe kontributin e jashtëzakonshëm që jep për komunitetin shqiptar të Anës së Malit në Nju Jork dhe që me atdhedashurinë dhe respektin që ka për vendlindjen, vlerat e këtij komuniteti i sjellë në trojet e të parëve.

Në fjalën e rastit vetë Naser Nika tha se në një të ardhme të afërt, në një nga rrugët e State Island do të ngrihet një Përmendore kushtuar Heroit Tonë Kombëtar Ismail Qemali, çka lë të kuptohet se patriotizmi dhe vëmendja e këtij organizatori ndaj historisë sonë kombëtare është i jashtëzakonshëm.

Gjithastu z.Naser Nika mes emocioneve dhe gëzimit falenderoi pjesëmarrësit dhe përkrahësit e kësaj nisme, shumica të pranishëm në këtë mbrëmje, qëllimi i së cilës do të forcojë lidhjet mes diasporës dhe vendlindjes, ku vëmendjen kryesore do ta ketë brezi i ri.

Ky eveniment madhështor duhet të kthehet në traditë në mënyrë që bijtë tanë të lidhen edhe më shumë me njëri-tjetrin dhe fëmijët tanë të mos e humbin gjuhën dhe identitetin e tyre kudo ku ata jetojnë e punojnë nëpër botë, por ta trashëgojnë



edhe ata si një amanet që duhet mbajtur gjallë.

Siç e thamë më lart ky manifestim kishte edhe mbështetjen e institucione-



ve vendore dhe qëndrore, ku duhet të vlerësohet Ministri i të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave në Mal të Zi z. Fatmir Gjecka, Komuna e Ulqinit me kryetarin Omer Bajraktari, Organizata Turistike e Ulqinit me drejtorin e saj Gëzim Hajdinaga, Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Malin e Zi me kryetarin Faik Nika, Shoqata “Ulqini” në Nju Jork, si dhe Teatri “Teuta” në Ulqin me në krye Munib Abazin.

Unë e ndjej për detyrë që të përgëzoj në këtë shkrim kolegët e mi të medias, për pasqyrimin e kësaj feste madhështore, Televizionin “Teuta” në Ulqin, Televizioni RTSH Shkodra me gazetarin dhe

moderatorin e mirënjohur Marjo Gjini, si dhe operatorin Medin Guri, të cilat përcollën emocionet e këtij spektakli, duke sjellë nëpërmjet këngëve dhe humorit, jo vetëm freskinë e detit, por edhe performancën e artistëve që i dhanë vlera këtij organizimi kaq të bukur.

U ndala tek organizimi i këtij aktiviteti që dalngadalë po krijon traditë, tek organizatorët dhe sponsorët e tij, por natyrisht asnjë sukses nuk do të ishte arritur pa artistë të mrekullueshëm vendas, shkodranë e deri në Diasporë, që natyrisht janë të kësaj origjine dhe botës të kësaj kënge kaq të bukur shqiptare.

Të mrekullueshëm u ngjiten në skenë dhe po kaq të mrekullueshëm performuan në këtë natë magjike në Ulqinin e lashtë këngëtarët: Gëzim Nika, Hajro Ceka, Gjylie Pelinku, Nexhat Kaleziq, Eliza Markiq, Icko Hasanga, Elisabeta Marku, Lulka Merkulaj, Elvira Fierza, Ramazan Islami, Samir Veliq, Shtjefen Ujkaj, shoqëruar nga instrumentistët e talentuar Nazmi Islami, Ardit Seferi dhe Ardit Nika, si dhe Grupi “Akustik Bend” me Jonuz Muharremin. Këtij “Bendi” iu bashkëngjiti një nga fizarmonicistët e parë në Ulqin, Dino Milla.



Me këngët e tyre të bukura ata sollën me shumë dashuri dhe emocion në zemrat e publikut mallin për vendlindjen. Të gjitha këngët u interpretuan live, një performancë që i dha akoma më shumë vlera këtij spektakli.

Restorant “Lamiga”, i cili kishte hapur krahët e mikpritjes dhe që kishte shtruar sofrën bujare të kësaj mbrëmje, kërkonte dhe një buzëqeshje, kërkonte një humor, të cilin me performancën e tyre ia sollën humoristët e mrekullueshëm të grupit “Gaz e maraz” Gac Kodrina dhe Qazim Çela.

Çdo aktivitet i këtij niveli ka gjithmonë përkujdesjen e dashamirësve që kontribuojnë larg interesave financiare, por që i lidhin me krenarinë kombëtare. Kështu meritojnë respekt sponsorët e këtij aktiviteti; Firma “Repex”, me president Jakup Gjeshin, Restorant “Lamiga”, Akademinë Multi Funksionale “Afrodra” me presidente Aferdita Ferracaku, Grupi Muzikor “Ceka”, si dhe Jehona e Shkodrës me producent Xhelal Halili.

Këtë ngjarje që i kalon përmasat e një shfaqjeje, unë e përjetova me shumë emocion, mbajta shënime dhe i hodha në këtë shkrim, ku pasqyrova jo vetëm punën e palodhur të organizatorëve, sponsorëve, por edhe të pjesëmarrësve, artistëve e spektatorëve.

Në gjithë këtë gamë kaq të bukur e shumë ngjyrëshe të “Diaspora në vendlindje” si një penelatë erdhi në këtë tablo artistike moderatorja e talentuar Dafina Teliqi, e cila me shumë emocion tha se të moderosh aktivitetet është gjithmonë kënaqsi.

Kjo mbrëmje që sfidoi këtë gusht të nxehtë do të mbetet në kujtesën e organizatorëve e artistëve, por veçanërisht e spektatorëve, pasi ata nuk ishin vetëm banorët e Ulqinit, por edhe bijtë e bijat, nipërit e mbesat e tyre, të cilët kishin ardhur të festojnë së bashku në këtë qytet të mrekullueshëm.

Kjo festë tregoi edhe njëherë se Shoqata “Ana e Malit” dhe Shoqata “Kraja” po mbajnë gjallë jetën e këtij komuniteti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sikur të ishin në trojet e veta, për çka jo vetëm si gazetar, por edhe me origjinë nga kjo krahinë, gjej rastin t'i falenderoj dhe përgëzoj për punën e lavdërueshme e të jashtëzakonshme që ata bëjnë për vendin e tyre.

Festa vazhdoi deri në orët e para të mëngjesit, ku performancat e këngëtarëve të mrekullueshëm Gëzim Nika, Hajro Ceka, Elisabeta Marku dhe Elvira Fierza nuk u mjaftuan me skenën e përgatitur, por u shkruinë me publikun, duke interpretuar në një skenë të madhe.

Kjo skenë e madhe i bëri bashkë artistët dhe spektatorët, të cilë kënduan e vallzuan së bashku, duke i dhënë kësaj feste një atmosferë të jashtëzakonshme.

Nga Ramazan Çeka, Gusht 2022

# Curraj i Epërm, me trashëgiminë e besimit në Zot, Vatikani dhe Shën Pjetri i Alpeve Shqiptare

Më 6 gusht, 2022, në Curraj të Epërm, u bë promovimi i restaurimit të Kishës 125 vjeçare, e cila u rezistoi rrebesheve të kohës deri më sot.

Kjo ditë, e bekuar për këtë bashkësi, u realizua përmes nismës dhe lobimit të bijve të kësaj treve, kryesuar nga zoti Skënder Përpepaj, të cilët punojnë dhe jetojnë jashtë Atdheut, duke qenë edhe organizatorët kryesorë të organizimit dhe strukturimit të kësaj veprimtarie. Është një mirënjohje ndaj tyre që do të jetojë gjatë në memorien e banorëve të kësaj famullie.

Përveç banorëve të famullisë, tashmë të shpërndarë brenda e jashtë Shqipërisë, në Evropë dhe Amerikë, ishin të pranishëm edhe besimtarë nga treva nikajmërturase, Dukagjin e Kosovë, por edhe përfaqësues zyrtarë nga Malësia e Gjakovës, Dibra, Puka, Kosova, kryeqyteti shqiptar, Vlora, Mali i Zi dhe Diaspora.

Veprimtaria, e motivuar në emër të këtij objekti kulti, simbol besimi dhe kulture i fshatit tonë, mori pagëzim dhe bekim nga përfaqësuesi i dioqezës së Sapës, monsinjor Simon Kulli, bashkë me meshtarë të tjerë, që kremtoi dhe meshën e shenjtë, në objektin e restauruar dhe me fytyrë të re, mbushur përplot me besimtarë, brenda e jashtë saj.

Përmes fjalëve të zotit, monsinjor Simon Kulli, falënderoi banorët e famullisë dhe sponsorët, listuar emër për emër (Skënder Përpepaj, Gaspër Prebibaj, Nikolin Vatnikaj, Fran Vukaj, Mhill Prebibaj, Skënder Qokaj, Prelë Përpepaj, Besnik Vatnikaj, Gegë Prebibaj dhe Agron Përpepaj), që bënë të mundur rinovimin e objektit. Gjithashtu përcollti dhe mesazhe të dobishme ndaj besimtarëve për ruajtjen e Kishës, për lutje dhe pastrim shpirtëror të tyre, pasurim dhe mirëmbajtje të objektit, por edhe zhvillim të zonës, duke ruajtur identitetin e gjithçkaje që posedon kjo zonë, sidomos pronësinë mbi tokën, duke kujtuar edhe përbetimin e të parëve të këtij katundi.

Veprimtaria promovues, me banorët e fshatit, të ftuar zyrtarë, artistë të fjalës, këngës dhe muzikës të këtij fshati, trevës nikajmërturase dhe Malësi e Gjakovës, u zhvillua në Logjet e Mrishajve, strukturuar dhe kompozuar nga ciceronët Ndue Vatnikaj dhe Alma Mehmeti, të cilët me zërin kumbues dhe elegant njëkohësisht, elektrizuan mbarë të pranishmit, me këngëtarë, valltare dhe instrumentistë virtuoze, të ardhur enkas për këtë rast gëzimi dhe bashkimi.

Fjala përshëndetëse e zotit Skënder Përpepaj, si nismëtar i restaurimit, bashkë me grupin e mundësorëve dhe mjeshtërve të objektit, i bëri rezyme të gjatë histo-



risë së kishës, banorëve qëndrestarë në rrjedhë të viteve dhe kthimit në identitet që nga 1897-ta deri më sot. Gjithashtu, me rëndësi ishin fjalët përshëndetëse të përfaqësuesve zyrtarë, si treshe bashkëpunuese dhe firmëtare e zhvillimit turistik të zonës mes Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së Kosovës, me ministre zonjën Rozeta Hajdari, bijë nikajmërturase, kryetarit të bashkisë Tropojë, zotit Rexhë Byberi dhe zotit Skënder Thaçi, kryetar i shoqatës për promovimin e turizmit malor të Kosovës, si dhe shpalosja vizive e Kreut të bashkisë Tropojë, për përfshirjen në 115 fshatrat turistike, edhe të Currajve të Epërm, që u duartrokitën nga të pranishmit, me shpresën se, edhe fytyra zyrtare do i kthejë sytë prej kësaj ane, e braktisur tash 110 vjet shtet.

Mesazhet e folësve Lavdrim Krrashi, deputet i parlamentit shqiptar, Abdulla Domi, kryetar i Këshillit të Qarkut, Kukës, kryetarit të bashkisë, Pukë, zotit Gjon Gjonaj, përveç konstatimeve për bukurinë natyrore dhe njerëzore të kësaj

treve, i mëshuan nxitjes së investimeve konkrete zyrtare në zonë dhe reklamimit të kësaj treve turistike e të tjera.

Kreu i shoqatës "Nikaj-Mërtur", zoti Gjin Progni, i mëshoi faktit që të trokitet më shumë në institucionet zyrtare, që fjalët e bukura të mos ngelen në kuadrin e konstatimeve romantike, por të ketë projekte konkrete zhvillimore për turizmin në Curraj të Epërm. Zoti Mëhill Gecaj, si veprimtar aktiv dje dhe sot për zhvillimin e kësaj perle natyrore, pasi përshëndeti gjithë të pranishmit, theksoi investimin dhe zhvillimin serioz, që duhet të marrë kjo bukuri natyrore, që të konkurrohet me treva të tjera turistike.

Ish Ambasadori Mal Berisha në Mbretërinë e Bashkuar, që erdhi enkas me avion për të vizituar dhe promovuar këtë trevë, edhe pse me heshtjen e Tij, shfaqti shumë dashamirësi dhe obligim ndaj këtij fshati, me potencialet dhe frymën e Tij, si njeri i ditur i punëve konkrete, Britani, Amerikë, Kosovë, Shqipëri, por edhe si nostalgjik i Currajve të Epërm, pasi babai i Tij, Bajram Zeqir Berisha, kishte shër-

byer si mësues në shkollën e këtij fshati në vitet 1949-1950, i cili privatisht u shpreh: "Banorët e Currajt të Epërm janë nga njerëzit më inteligjentë, më të shkolluar, patriotë dhe të talentuar të Malësisë së Gjakovës".

Po ashtu edhe zoti Flamur Gashi, si ish ambasador dhe Këshilltar i Presidentit për Rajonin nderoi me pjesëmarrjen e Tij, duke qenë një dashamirës i kësaj treve përmes lidhjes gjenin me Malësinë e Gjakovës.

Kryetari i shoqatës "Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm", zoti Lekë Hysenaj, si përfaqësuesi real juridik i tëra lagjeve të fshatit Curraj i Epërm, pasi bëri përshëndetjen ndaj tërë të pranishmëve në këtë ditë shprese dhe besimi, për ditë më të mira në këtë fshat, u ndal në disa pika kyçe që janë sintezë e mendimit unanimit të të gjithë të pranishmëve dashamirës, që në këtë fshat turistik të mbizotërojë besimi në Zot, paqja, dashuria, bashkimi dhe zhvillimi real turistik, miratuar kjo edhe në kryesinë e shoqatës, të cilën si Union po e japim në ligjëratë të drejtë.

"M'lejoni që, si njani prej banorëve të këtij fshati simbol, por edhe si përfaqësues juridik i krejt lagjeve të kësaj treve, t'u thom për zemërsisht: Mirë se u bashkuem e mirë se u pruni Zoti e kjo ditë!

S'pari, urimi ynë shpirtëror, bashkë me gëzimin e kësaj dite, shkon për te tanë banorët e këtij fshati, emën për emën, por, veçantë, për bijtë tanë, që jua dha zëmra e xhepi me restaurue ket' objekti kulti, me nismëtar dhe organizator zotin Skënder Përpepaj dhe grupin dashamirës që ju ngjit nismës së 'Tij, tuj ba që kjo ditë e bekueme të marrë ma shumë dritë në ket' Sukë kishë e në 'shpinë e Zotit. Bekoj Zot tanë ndihmaqart' e kësaj Kishë!

Patjetër sot duhet me jua përcjellë një mirënjohje, due me thanë, bash speciale, në emnin tonë si fshat, por edhe nga përfaqësues baritorë të kishës, si kanë ardhë me na bekue Ne e kishën se, familja e Grimc Demës (Prebibaj), e meriton një miradije tonën, se ruejtën të mshefun, në kohën e errët të diktaturës, për rreth 25 vjet, truporen e Shnandout dhe kumbonën e kësaj kishë e, falë atyne, në 'filimet e Demokracisë, ju kthyen kësaj shpie hyjnore për shërbesat tona fetare.

Nji falnderim të madh, edhe një herë, e kena për nismatart e realizuesit e rrugës së makins në tetor, 2018, ku banorët e këtij fshati, mrenda e jashta atdheut, banë mrekullinë tuj grishë xhepin e tyne e, falë kësaj rruge, jena sot në kto Logje e në ket' Sukë kishë, me te tana ngjyrat tona njerëzore e religjioze.

Mirënjohje të përhershme për Ne meri-



tojnë edhe fiset Nikaj-Mërtur, Shalë e Shosh, Gash e Krasniqe e deri në 'Kosovë që ju bashkuen piskamës sonë, si dikur ndër mote, që boria e makinës të kumbonte edhe në Curraj t'Epër. Zoti i bekoftë këto fise legjendare që kanë ba e bajnë historinë, së bashku me Ne!

S'dyti, ekzistenca e ksaj shpie Zoti, tash

e restaurueme në mënyrën tonë modeste, (ndërtue me 1897) ka mbet' n' kambë, falë burrave qindrestarë e t'ditun të ktij fshati, të cillt, përmes fjalëve të Kukel Ndout, banë që ky objekt të mbetet i gjallë deri tash, tuj kanë ndër t'rallat objekte fetare që i bani ballë regjimit famëmkeq t'komunizmit.

Prandaj, ky objekt besimi, ashtë simboli dhe Vatikani ynë i shenjtë, Suka e kishës ashtë Shën Pjetri ynë, ndërsa Kisha jonë e Shnandout, si t'lumt Na për ta, ashtë jo vetëm pastrimi ynë shpirtnor dhe forcimi i besimit në Zot, por mban në gjinin e ktij fshati dhe krejt pozicionit t'vet gjeografik, historinë, kulturën tonë materiale dhe shpirtnore, qindresën, mbijetesën dhe të drejtën tonë tradicionale, si një bashkësi njerëzor që, rrallë kund, e gjen në trevat Veriore të Shqipërisë, sikur na i ka falë Ai, si p'e thom prapë, t'Lum't Na për Ta, si po i rreshtoj si ma poshtë:

- Një mjedis gjeografik me peizazh, ekosistem dhe monumente natyrore të një lloji të veçantë që konkurrojnë me shumë treva të shpalluna turistike, parqe kombëtare apo zona të mbrojtuna e të tjera, pra, mjedis aristokrat, por që, paradoksalisht, regjimet e lanë popull të varfën, por sot, po të ketë infrastrukturën e duhur dhe zhvillimin ndërtues tonin, çdo turist, vendas apo i huaj, mund të përmbushë një guidë të plotë turistike vetëm në fshatin tonë alpin, plus Qeresh-Kuç e Mulaj.

- Llojshmëni t'papame herbariumesh, bjeshkë e vërri, sa me ngjallë edhe t'dekunin.

- Nji kulturë tonën shpirtnore, të pasqyrueme në "Visaret e Kombit", që mbahet si krenaria e folklorit shqiptar. Aedët e kësaj treve me Mirash Gjonin, Lulash Zefin, Mhill Prekën, Dedë e Shan Zefin, me rapsoditë e tyne, konkurrojnë Homerin e grekëve, kangët e Rolandit të francezëve, të Sidit të spanjollëve apo të Nibelungëve të eposit gjerman, madje përshkrimi si i ashtë ba Tanushës së Krajlit (marrë nga Mirash Gjoni) konkurron Laurën e Petrarkës të italianëve. Janë, këto, pohime studiuesish kompetentë dhe jo prodhime fantazie.

- Një etnografi të foluni, si gjuhësi e folësve, që pasqyron larminë tonë komunikuese, të lashtë e të re, me leksik, frazeologji dhe onomastikë shumë të pasun, me të cillën mund të mbrohen disa grada shkencore.

- Toka, bjeshkë e vërri, me kufij pronësorë të padiskutueshëm dhe të patjetërsueshëm, posedue pa ndërpemje dhe e fiksueme saktë, gati qe 300 vjet e kndej, simbas t' drejtës tradicionale, madje, mu në ket' Sukë kishë, burrat e te tana lagjeve tona, mbytën "gurët e besë", në vendin e quajturn "Pusi i Kishës", simbas formulës së betimit se, toka e tyne dhe e fshati, s'do të shitej, falej a tjetërsohej kurrë jashta tij.

S'treti, si përfaqësues zyrtar juridik i shoqatës "Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm", me tanë zanat e fortë të krejt vllaznive të ktij fshati, japim fjalën tonë të nderit, besës e ligjit, me aq sa kena mundësinë se, me përkushtimin tonë maksimal dhe frymën Tuej të sinqertë mbështetëse, do të jena vetëm të dobishim e jo t'randsishim, do t'bajmë maksimumin te institucionet zyrtare të shtetit shqiptar, organizmat joqeveritarë,



mrenda e jashta Atdheut, që t'jua kthejmë sytë drejt zhvillimit konkret të kësaj perle natyrore dhe njerëzore, si e lakojmë kaq shpesh edhe në rrjetet tona sociale, falë teknologjisë, duke shmangë me traditë e ligj çdo ndërhyjmë individash apo grupi individash që janë ka kacavjerren me ba për veti ndonjë kashatë të vogël a t' madhe, për interesa vetjake, se, si e thotë Pashko Vasa "... ashtë tokë e jona e t'part na e kanë lanë...". Mos me na mashtrua kush në pronën tanë, se, zhvilluesit e saj jena veç Na!

S'fundi, po u baj një apel njerëzor dhe vllaznor, që ta ruajmë me fanatizëm ket' objekt besimi, ta hyjnizojmë ata, me figura religjioze në vite, dhe ky restaurim me na shërbye edhe si shtysë e fortë për rregullimin edhe t' shpive tona, tuj ruejt ftyrën dhe stilin tonë alpin, qysh e kena trashgue prej t'parve, tuj i përshtat edhe t'rene, edhe t'vjetrën.

Zoti i bekoftë tanë banorët e Currajve t'Epërm, fshatin dhe dashamirët tanë, si na nderuen me pjesëmarrjen e tyne, e falë Zotit edhe bashkimi prej ksaj Kishë dhe dashtnija jonë besimtare na shoqnoftë gjithmonë! Faleminderit te tanve, n'ket ditë t'lumnueme!"

Dedë Qokaj



# I PAHARRUARI NDOC SELIMI

Zakonisht për njerëzit që bëjnë një jetë të thjeshtë, kalimi në amshim shihet si një ritual i kushtëzuar nga cikli i jetës, por ndryshe nga këta njerëz modest, disa prej tyre bëjnë një jetë shumë më aktive, duke fituar kështu një emër të përveçëm në shoqëri, çka i bën të mbeten të paharruar edhe pas largimit nga kjo botë. I tillë ishte edhe vizionari mendjendritur, miku dhe bashkëpunëtori i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i paharruari Ndoc Selimi, i cili pikërisht me 21 gusht 2022 mbush plot dy vite nga kalimi i tij në amshim.

Është e pabesueshme edhe sot e kësaj dite se, si një burrë shtatnalt, me një zell pune të pandalshëm, të veshur me një ambicie të jashtëzakonshme për të gërmuar që nga galeritë e arkivave më të shquara të kohës, e deri në të eksploruarit të terreneve, për të nxjerrë në dritë të dhëna historike e kulturore mbi të vërtetat shkencore, të cilat veshin me dinjitet identitetin shqiptar, të shuhet aq papritur dhe në kushtet e një distancimi të kushtëzuar social nga prezenca e “Pandemisë Globale”, sa të mos i jepnim as “Lamtumirën” e fundit.

Ndoshta kjo e bën akoma edhe sot prezentë praninë e tij, si një shtegtarë që vinte e shkonte kohë pas kohe në mërgim, por pa e harruar asnjëherë vendlindjen, shoqërinë dhe varrin e prindërve të tij, atje në kodrat e blerume të Komanit, ku sot prehet i qetë pranë tyre, i paharruari Ndoc Selimi.

Janë të pafundme shkrimet, dorëshkrimet dhe referatet, të cilat mbajnë autorësinë e studiuesit Ndoc Selimi, ku secili lexues mund të përftojë dhe pasurojë dijet e veta nga të dhënat e përmbajtjes së këtyre materialeve të shkruara, që nga ato publicistike, e deri tek ato me baza shkencore.

Një nga dorëshkrimet e tij më të spikatura i përmbledhur në formatin LIBËR është “Kultura e Komanit”, i cili nga opinionistët është vlerësuar si një libër i mirëfilltë shkencor i kopsitur me një logjikë të rrallë studimore, që dëshmon dhe hedh dritë mbi urat e zhvillimit social të periudhës së errët të mesjetës, të bazuar mbi të dhëna të shkruara burimore dhe fondi i gjetjeve arkeologjike, shumë prej të cilave të rastësishme nga banorët vendas, bashkëfshatarët e tij, si dhe gërmimet e tij pasionante prej studiuesi autokton.

Me po kaq vlerë janë edhe poezitë e tij të skalitura me një pendë të hollë e peshuar mbi përvojën e jetës së tij gjithë ulje - ngritje, të cilat fjalë pas fjale e varg pas vargu dëshmojnë për një frymë jete të jetuar në prezencë e në arrati, si vetë jeta shtegtare e këtij poeti me shpirt të lirë edhe pse profesionet e tij në jetë ishin nga më ekstremet, që nga pilot dhe ushtarak, e deri tek murator, marangoz dhe koordina-



tor i një strehe bamirësie.

Vitet e fundit të jetës së tij u riatdhesuar përfundimisht për të shijuar moshën e pleqërisë si një pensionist paqësor dhe për të nxjerrë mallin e vendlindjes aq shumë të munguar. Megjithatë ambicia e tij nuk e tradhtoi për asnjë çast pasi: “njeriu duhet të punojë sa të ketë frymë, thoshte Ndoc Selimi”, ndaj kohën e lirë ia kushtoi plotësisht një studimi të thelluar shkencor mbi zonën e Dukagjinit, ku gjatë gjithë kohës e gjeje në biblioteka, librari e në intervista me njerëz, të cilët në vetëdijen e tyre ruanin gojëdhëna që kishin interes për studimin në fjalë. Studim, i cili për fat të keq edhe pse ishte përfunduar sa ishte i gjallë autori, akoma as sot nuk e ka parë dritën e botimit, gjë që e themi me bindje se do jetë një nga librat më të spikatur për sa i përket tematikës që ai studim mbart.

Me interesin për ta pasur sa më parë në dorë jo vetëm si studim që lidhet me zonën tonë, por edhe për t’ju shtuar fondit të shkruar burimor shkencor historiografisë shqiptare, në një bisedë paraprake me znj.

Prenda Selimi, bashkëshorten e të ndjerit Ndoc Selimi, si dhe djemtë e tij, besojmë se së shpejti ky studim do vijë në dorë të lexuesit, shumë prej të cilëve dashamirës të autorit e presin me padurim mendimin dhe fjalën e tij, të shkruar si një mundësi e të biseduarit edhe pa prezencë me të paharruarin Ndoc Selimi.

Janë përvojat e jetës, të cilat e bënë këtë njeri human dhe mirënjohës ndaj Zotit, njeriut dhe fatit, gjë që nuk nguronte t’i ndante me dashamirësit e tij sa herë gjendej në mesin e tyre.

Këto janë disa nga të shumtat arsye përse kujtimi ndaj tij krijon mall dhe mungesë të pazakontë, gjë që na vjen natyrshëm të urojmë:

I PËRJETSHËM QOFTË  
KUJTIMI I TIJ!

Nga Rita Shkurtaç  
e Ndue Sanaj, gusht 2022

# PAK HISTORI NGA HISTORIA E CERNICËS... HISTORIA VIJON

Fort të nderuar dhe të respektuar bashkëqytetas mirë se u bashkuam në Cernicën tonë të bekuar! Grupi nismëtar i këtij takimi, më ngarkoj dhe njëkohësisht më nderoj mua, që të paraqes diçka për historikun e qytetës sonë dhe unë po e filloj me disa vargje ...: *“Shtatëdhjet vjet e pak permi, / Ktu në Cernicë krejt pyll i zi, / shkulem lisa e ngrehem shpi, / çelem tokë e rritem fëmijë ...”*

Të paktën kështu filloi historia e fshatit më të ri në Malësinë e Gjakovës. Në pyllin shumë shekullor, ku nuk mund të kalojë i vetëm, filluan të tymosen oxhaqet e para e të çelej pak tokë sa për të mbajtur frymën gjallë.

Në fillim askush nuk e dinte hapësirën e pamat të kësaj pllaje e nuk dinte as se cilin kishte fqinj. Nder banoret e pare, që erdhën ishin nga Betosha, Gjonpepaj, Raja e Curraj Epërm.

Me aq pak tokë sa çelej me krah nuk mund ti behej ballë jetesës. Shteti i kohës solli traktorët e parë të markës “Stalines” dhe manovratorët e parë ishin Budo Isufi e Kolë Shahini nga Shkodra, si dhe Zef Avdia, Miter Kola e Zef Pjetra nga Nikaj Merturi.

Hapësirat e reja të tokës, që u shpyllëzuan nuk mund të punoheshin ma me krah. Mbaruan kurset për traktorist djemtë e parë të Cernices Fran Deda, Prend Baftia, Fran Hasani, Mark Susaj, Pjeter Bala, Dedë Steaj e të tjerë. Më vonë u kualifikua edhe traktoristja e parë Dukate Mehili Bushgjokaj. Manovratorët e parë të traktorëve me goma, ose zeturve ishin Lulash Gjeloşi, Idriz Mala. Vasil Zefi, Sokol Ukcama e të tjerë.

Cernica në atë kohë ishte një vend i pa vade. U deshtë një burrë fisnik dhe i shkolluar nga Nikaj Merturi, me emrin Sokol Meshi, që të projektonte dhe të ndërtonte me burrat fisnik e punëtor të Cernicës kanalën e Begajve, një nder veprat më të mëdha e të vështira për kohën.

Filloi të ndërtohej qyteti i Bajram Currit dhe nevoja për shofer u bë e ngutshme. Nder të parët që kryen kurset dhe u aftësuan për shofer ishin Ndue Pali, Lulash Nika, Mark Geci, Nikoll e Shefqet Hamza, Gjon Mici, Martin Kola, Sokol Zefi, Mirash Frani, Mehili Rama e të tjerë. Theksojmë se nga qyteza e jonë doli dhe shoferja e parë, Leze Kolndreu.

Është vendi të përmendim këtu drejtuesit e parë të kooperativa bujqësore, si Mehmet Ponari, Zenel Zheli, Hasan Motina dhe më vonë drejtoret e ndërmarrjes së parë Bujqësore të Veriut Brahim Kadria, Rrustem Berisha, Gjon Kolbuçaj e Gjok Malaj.

Përveçse për punë krah u bë imediate nevoja për ekonomist, brigadier, financiar, që duhet përmendur Gjok Nike Kolndreu, Sokol Ukcama, Nikoll Hames Pjeternikaj, Dede Zmajl Gjoklaj, Nikoll Mehmeti; agronomi i talentuar e punëtor Gjon Rama, Gjon Zhivanaj, Lule Ndrepepaj, Mark Kacuni, Gjon Nike Pjetergjokaj, Sabrie Vesel e të tjerë.

Në fshat u ndërtua shkolla e parë mëri në sektorin e shëndetësisë Maksim



dhe mësuesit e parë ishin Azem Hoxha, Skënder Gjoca, Lule Maleti e Muharrem Gashi. Të parët që u diplomuan për mësues ishin Mark Zogu, Fran Bushgjokaj, Marash Mehili, Gjon Geci, Ndue Lepuri, Ndue, Nike e Fran Ukcama, Dede Markaj, Gjeloşi e Mark Pjetergjokaj, Zef Ukcama, Gofile Mrishaj, Rama e Mira Mark Gci, Dukate Susaj e të tjerë.

U diplomuan dhe punuan me devotsh-

tor e drejtues emisionesh në RTSH; Drita Mehili, me detyrë sekretare e parë e rinise së rrethit dhe më vonë kryetare e guas së rrethit; Fran Bushgjoka dy here drejtor i gjimnazit në qytetin e Bajram Currit, drejtor i shkollës së mesme në Llugaj dhe i pari kryetar i komunës në Llugaj; Luçie Geci drejtore dhe shkollës tetëvjeçare në Llugaj dhe kryetare e këshillit të bashkuar të Ndërmarrjes Bujqësore; Afrim Krasniqi

drejtor i studimeve politike dhe këshilltar i Presidentit të republikës së Shqipërisë; Marash Mehili drejtor i pallatit të kulturës “Dardania” dhe i shtëpisë së kulturës Fierze; Martin Lulash Geci kryeinxhinier i ndërmarrjes gjeologjike të rrethit dhe drejtor i Albimpesksit; Fran Ukcama drejtor i shtëpisë së kulturës në Fierze; Can Ukcama drejtori i ndërmarrjes gjeologjike të rrethit; Mark Dede Mici shefi katedrës së përgatitjes fizike në shkollën ushtarake Tiranë; Zef Ukcama drejtor i shkollës së mesme “Leke Çokaj” në Cernicë; Ndoc Ndreaj përgjegjës i shtëpisë së kulturës Llugaj; Lazer Gjeloşi drejtor i policisë ushtarake Tiranë; Ndue Lepuri i pari përgjegjës i shtëpisë së kulturës në Llugaj dhe të tjerë.

Nëntoka e Malësisë ishte plote me minerale dhe kishte nevojë për zbulimin e drejtimin e tyre. Kryen studime shkëlqyeshëm dhe punuan në këtë sektor të rëndësishëm inxhinieret gjeolog të talentuar Martin Lulash Geci, Can Ukcama dhe Zeqit Ndrepepaj.

Përveç punës cernicase kishin nevojë edhe për argëtim kulturor e sportiv. Këtu ku jemi u ndërtua vatra e kulturës, në të cilën punonjësja e pare ishte Zoje Mark Gjergjndreaj. Më vonë u ndërtua edhe salla e madhe e shfaqjeve me përgjegjës Dede Mrishen, i cili me amatoret e teatrit dhe ansambllit zunë vijimisht vende nderi në shkallë rrethi. Sporti u bë shumë popullor dhe masiv. Ekipi i mundjes “Valbona” pothuajse në të gjitha peshat kishte kampion nga djemtë e Cernices, si mjeshtri i sportit Ndoc Qokaj, Sokol Ramaj, Nikoll Ndrepepaj, Gasper Gjoka, Fran Hasani, Kostadin Ukcama e të tjerë. Ekipi i futbollit të Cernices u bë i frikshëm në spartakiadat në shkallë rrethi. Një nder futbollistët e parë të ekipit “Valbona” luajti për këtë skuadër nga vitit 1962-1975, me 192 ndeshje me këtë ekip ishte djali i cernices Fran Marku.

... djem, vajza e gra të cernices drejtuan struktura të rëndësishme në shkallë rrethi e vendi, nder të cilët ishin Ndue Ukcama Leka, i pari drejtor i shtëpisë së kulturës së rrethit dhe më vonë opera-

tor e drejtues emisionesh në RTSH; Drita Mehili, me detyrë sekretare e parë e rinise së rrethit dhe më vonë kryetare e guas së rrethit; Fran Bushgjoka dy here drejtor i gjimnazit në qytetin e Bajram Currit, drejtor i shkollës së mesme në Llugaj dhe i pari kryetar i komunës në Llugaj; Luçie Geci drejtore dhe shkollës tetëvjeçare në Llugaj dhe kryetare e këshillit të bashkuar të Ndërmarrjes Bujqësore; Afrim Krasniqi

drejtor i studimeve politike dhe këshilltar i Presidentit të republikës së Shqipërisë; Marash Mehili drejtor i pallatit të kulturës “Dardania” dhe i shtëpisë së kulturës Fierze; Martin Lulash Geci kryeinxhinier i ndërmarrjes gjeologjike të rrethit dhe drejtor i Albimpesksit; Fran Ukcama drejtor i shtëpisë së kulturës në Fierze; Can Ukcama drejtori i ndërmarrjes gjeologjike të rrethit; Mark Dede Mici shefi katedrës së përgatitjes fizike në shkollën ushtarake Tiranë; Zef Ukcama drejtor i shkollës së mesme “Leke Çokaj” në Cernicë; Ndoc Ndreaj përgjegjës i shtëpisë së kulturës Llugaj; Lazer Gjeloşi drejtor i policisë ushtarake Tiranë; Ndue Lepuri i pari përgjegjës i shtëpisë së kulturës në Llugaj dhe të tjerë.

Janë nderuar me çmime të ndryshme: Ndue Ukcama Leka-“Mjeshtër i Madh i Punës”; Buibe Mici Lauante e Çmimit të Republikës; Gjeloşi Marku, me dekoratën “Naim Frashri”; Fran Bushgjokaj, me medaljen “Mirënjohja”, me rastin e 100 vjetorit të shkollës së pare shqipe dhe me dekoratën “Naim Frashri”; Marash Mehili, me titullin “Qytetar Nderi i qytetit Bajram Curri”; Ndue Lepuri me titullin “Qytetar Nderi i Komunës Llugaj” e të tjerë.

Në fillim të këtij shkrimi homazh theksova, se të ardhurit nuk dinin se cilët kishin fqinj, por shpejt ata u njohën, u kumbarisen dhe u miqësuan nderveti. Gjithashtu ata menduan edhe diçka tjetër të rëndësishëm, se rreth kësaj pyllnaje ata kishin të afërmit e gjenezës së tyre, si Kolgecet e Gjengecet e Kolgecajve, Mrk Gegen në Markaj, Gjonmakaj e Rrogamit e Nikgegajt e Luzhes, Kolmekshajt e Kolmakat e Bujanit e të tjerë.

Është një rastësi e bukur, që nismëtari i pare për popullimin e Cernices ka qene burri i zgjuar dhe drejtuesi i komitetit ekzekutiv të rrethit Mehmet Rasme Dollapi dhe po nga kjo zone është dhe kryetari i bashkisë së rrethit zoti Rexhep Byberi, që së bashku me këshillin bashkiak dhe administratorin punëtor i Njësisë Administrative tonë Agron Cakri bënë të mundur, që Cernica të kthehet në një qytet model në Malësi.

Të dashurit e mi, unë u mundova të them diçka për këtë qyteze në kohën e shkuar; ndërsa për kohën e tashme flet vete ndryshimi, që është bërë nga djemtë e vajzat cernicake, që nuk e lëshuan truallin e tyre dhe të baballarëve. Ndihmese e madhe në këtë drejtim kane dhënë edhe emigrantet me rimitancat e tyre, të cilët i përgëzojmë me gjithë zemër, për kontributin e tyre në të gjitha fushat.

Nuk i kemi thënë të gjitha, por 15 gushti tjetër nuk është larg dhe do të mblidhemi dhe do të flasim e gëzojmë përsëri.

Ju falënderoj e ju përqafoj të gjithëve!

**Ndoc Ndreaj, gusht 2022**

# DUKAGJINASI ILIR BIGA, ATLETI I RRUGËVE E KISHËS KATOLIKE

Dukagjini me histori të pasur shekullore, me dhimbjet e gëzimet e veta, një orë e madhe e kombit në të gjitha etapat historike, me burra mendimtarë e strateg përballë të gjitha ortigjeve, me gra burresha në krenarinë dukagjinase, por sot të lumturon edhe më shumë frymëzimi i brezave me shikim nga vendlindja, nga Dukagjini i ynë i dashur!

Mësova se para afro rreth tre viteve më parë në New York një djalosh i burrëruar nga Gimaj - Shalë, vetëm 26 vjeçar e paska kapur damari i racës së pastër shqiptare në nacionalizmin e shëndoshë e dashurinë për vendlindjen.

Burri 26 vjeçar Ilir Biga, jeton në New York, pinjoll i racës më të pastër shqiptare, familjes së pashembullt dukagjinase në pesë breza, të vendosur në prehrin e Alpeve shqiptare, në vendin e eposit të kreshnikëve, pasuesi i Avdi Kola, Gjur Kola e Zef Avdia, i cili vendosë të krijojë e legalizojë në SHBA, Shoqatën Patriotike "Bajraktari", me

shikim të qartë për nga vendi i të parëve si qëndresa shekullore e identitetit tonë kombëtar.

Vitet pas "90-ës ishin zbrazja jo vetëm e Dukagjinit, por kudo për zonat rurale,



pasi vështirësitë për jetesë normale ishin mision i pamundur, ndaj dhe synimi ishte emigracioni e vendosja me banim në zonat urbane, por ajo çfarë befason me të riun Ilir Biga nga Gimaj, është ideja, organizimi, lobingu me shoqatën e deri duke e vendosur vetën si donator kryesor të gjithëçkaje në shërbim të fshatit të vet me histori e Dukagjinit në tërësi.

Ky është rasti unikal në Shqipëri kur një i ri hedh shikimin nga vendlindja, pasi kemi të bëjmë me brezin e ftohur shqiptar, jo vetëm për fshatin e vet, por edhe ftohje në nacionalizmin kombëtar, që tashmë kemi rastin pozitiv si shërbese- referenca më e mirë për përcjellje te brezat në ftohje atdhedashuricë.

Por, siç theksova më sipër për farën e mirë shqiptare, kjo është pasuri e thesar shqiptar kur ajo pasohet mëshirshëm e shpirtërisht, ndaj mbetet mesazhi: "Derë keni qenë, derë edhe sot, gjithmonë mbetësha dera e krenarisë Dukagjinase e shqiptare!"

Tashmë burri i Gimajve të Shalës orë Madhe, vendos të legalizojë Shoqatën "Bajraktari" (15 janar 2020), me përkatësinë e emrit të derës nga vjen, familja, e cila ka kushtuar ndër shekuj për Gimaj, Shalën e Dukagjinin, tashmë për t'u shndërruar në uragan veprash e projekteve për krejt Dukagjinin.

Sot do përmendi disa nga kryeveprat kësaj shoqate me kryetar zotin Ilir Biga.

Së pari organizoi ndërtimin e kompenjelit dhe restaurimin e plotë të Kishës

Gimaj.

Së dyti, ndërtoi rrugën e re shkëmbore e ujësjellësin e ri për te Kisha.

Së treti, rehabilitimin e rrugës nga Kisha - Ura Gimaj - lumi i Shalës, si dhe urën e re në Xhaferaj, e cila lidh Gimaj - NënMavriq- Breg Lumi.

Një tjetër vepër është ujësjellësi i ri 1400 m brenda në Gimaj, Radoj- Gimaj si dhe rezervati i ri.

Ndërsa pastrimi i malit për hapjen e rrugës për tensionin e lartë 1 000 vatësh, kabinë elektrike me transformator në shtyllë, si dhe ndihma për disa rikonstrukcione shtëpish.

Por, jo vetëm kaq për atletin nga Gimaj,- kryetarin e kësaj shoqate Amerikano - Dukagjinase; donator në objekte si; Truporja e Shna Ndout në Breg Lumi, ura e telit te zallin e Camajve, e deri në riparimin e rrugëve të tjera në Dukagjin.

Po ashtu një donator i të njëjtit gjak mbetet Gjovalin Biga, i cili pagoi kumonen e Kishës, që do të kumbojë përjetësisht.


Vërtetë një rast unikal, i pari i kësaj natyre në Shqipëri, i riu që befason me mrekullitë e veta për vendin e etërve, ky atleti i rrugëve e Kishës katolike.

Kombi ka nevojë në përcjelljen e këtij nacionalizmi të shëndoshë kombëtar.

Dukagjini identiteti ynë i fortë kombëtar!

**Nga Agron PREBIBAJ**

## Inteligjenca dhe varfëria



Legjenda e biologjisë, amerikani James D. Watson (1928), mbajtës i çmimit "Nobel" që në vitin 1962, ka thënë se: "Për nga natyra, unë e shikoj të ardhmen e Afrikës të errët për faktin se, të gjitha testet tregojnë që, IQ (kuota e inteligjencës) së afrikanëve është ndjeshëm më e ulët se ajo e jona".

Watson, nuk është biologu i parë dhe i vetëm që shpjegon se, kuota e inteligjencës së lëkurërtëve është më e ulët se ajo e lëkurëbardhëve.

Në vitin 1994, psikologu Richard Herrnstein (1930-1994) dhe politologu Charles Murray (1943), në librin e tyre me titull The Bell Curve (rezultatet e testeve të inteligjencës) deklaruan se, inteligjenca e lëkurërtëve është, të paktën, një herë më e ulët se ajo e lëkurëbardhëve. Ata eksperimentuan dhe testuan fëmijë të moshave të ndryshme shkollore, nga viti 1975 deri në 1990.

Profesori i Universitetit të Kalifornisë,

psikologu Arthur Jensen (1923-2012), 25 vjet më parë kishte deklaruar se, pjesa më e madhe e fëmijëve amerikanë, me rezultate të dobëta mësimore, janë lëkurërtët. Sipas tij, kjo vinte për faktin se kuota e inteligjencës së tyre, në krahasim me të bardhët, është shumë më e ulët.

Në periudhën e skllavërisë, regjimi amerikan, ua ndalonte lëkurërtëve arsimimin dhe kontaktin me librat. Një sjellje e tillë atje zgjati me gjenerata të tëra. Në raste të rralla, fëmijët lëkurërtët, mund të shkonin në shkollat të veçanta, të ndara nga ato të fëmijëve lëkurëbardhë, ku gjithëçka ishte mizerabël. Sipas Jensen, Herrnstein, Muray dhe Watson, një sjellje e tillë e regjimit ndaj fëmijëve lëkurërtët bëhej me qëllim për tua dëmtuar inteligjencën atyre dhe për rrjedhojë aftësinë intelektuale. Një gjë e tillë do të arrihej nëpërmjet mosshkollimit dhe varfërimit, material dhe shpirtëror.

Psikologët francez, Christiane Capron dhe Michel Duyme, u muarën për disa vite me radhë, me teste dhe eksperimentime, për të vërtetuar ndikimin e varfërisë mbi shkallën e zhvillimit të inteligjencës tek individit. Ata, si objekt të eksperimentimit, zgjodhën fëmijë të adaptuar. Kryesisht fëmijë me prejardhje nga familje të varfëra por, të adaptuar nga familje të pasura. Gjithashtu ata eksperimentuan edhe faktin se, çfarë ndodhë me fëmijët e familjeve të pasura kur adaptohen nga të varfëritë.

Hulumtimet e gjata i çuan ata në konkluzionin se, fëmijët e familjeve

të pasura, në të gjitha rastet kishin një kuotë më të lartë të inteligjencës se ata të familjeve të varfëra.

Konkluzioni i dytë ishte se, rrethanat sociale dhe ekonomike të familjes adaptuese, ushtrojnë një influencë të madhe, mbi intelektin e fëmijës së adoptuar. Fëmijët e familjeve të pasura, të adoptuar nga familjet e varfëra, mesatarisht kishin një kuotë të inteligjencës prej 107,5 pikësh. Fëmijët e familjeve të pasura, të adoptuar nga familje të pasura, kishin kuotën e inteligjencës 119,6 pikë. Siç shihet ndryshimi prej 12 pikësh, është i konsiderueshëm. Kjo tregon se mjedisi ka një influencë shumë të madhe mbi zhvillimin apo moszhvillimin e inteligjencës. Dhe kryesisht varfëria.

Psikologëve ju interesonte edhe fakti se, çfarë ndodhë me fëmijët e një familje, disa nga të cilët adoptohen nga familje të pasura dhe të tjerët rriten në familjen e tyre biologjike, të varfër.

Në testimet e inteligjencës së tyre, u vu re se, fëmijët e adoptuar arritën kuotën 107 deri 111 pikë ndërsa, ata, të rritur në familjet e tyre të varfëra, arritën vetëm kuotën 95 pikë. Një diferencë kjo shumë e madhe, për fëmijë të të njëjtit bark. Nuk kishte asnjë pikë dyshimi se shkaku ishte mjedisi social dhe veçanërisht varfëria.

Psikologët vazhdonin të hulumtonin edhe raste të tjera të mundshme, për ta bërë sa më të qartë influencën e varfërisë mbi inteligjencën. Zgjodhën dhe fëmijë të lënë pasdore dhe të adoptuar vonë nga familje të pasura.

Nga më se 5000 akte adoptimi, Michel Duyme zgjodhi disa nga fëmijët e moshës 5-6 vjeç, të keqtrajtuar në familjet e tyre biologjike. Tërheqja e tyre nga prindërit ishte bërë nga strukturat vendimmarrëse dhe, shumë prej tyre, përfunduan në fëmijë të adoptuar. Këta fëmijë, para se të ndaheshin nga prindërit e tyre biologjikë, sipas testeve të bëra kishin arritur kuotën e inteligjencës vetëm 60 deri në 86 pikë. Psikologun Duyme e alarmoi një rezultat i tillë. Fëmijët me test inteligjence nën 80 pikë mendohen fëmijë problematikë të shëndetit mendor. Çfarë mund të bënte, edhe më i pasuri, me fëmijë të tillë!?

Nga testimet që Duyme iu bëri këtyre fëmijëve, tashmë jo më fëmijë por, në moshën e adoleshencës, 12 -18 vjeç, pa se, ata që ishin rritur në familje me nivel mesatar jetese, e kishin përmirësuar kuotën me 8 pikë, ndërsa ata të rritur në familje të pasura me 19,5 pikë.

Varfëria qëllon mbi fëmijët me dy "gryka": Mbi shëndetin fizik dhe mendor.

Mjerisht, tek ne, nuk ka as studime dhe as statistika për kuotën e inteligjencës së fëmijëve. Ne merremi me politikë dhe, jo me shkencë. Kështu siç drejtohet kombi ynë, edhe për shumë dekada, do të mbetet "Botë e Tretë"

Hej, politikanë të çmendur, ku po e çoni kombin?

Jemi kombi më i varfër në Evropë.

Kjo do të thotë që, rinia e jonë, është me kuotën e inteligjencës më të ultë në Evropë.

**Lekë Imeraj-shkrimtar, përkthyes, publicist**

# I BURGOSUR NE MOSHEN 82 VJEÇARE NDËRROI JETË NGA TORTURAT 5 VJET MË VONË

Kleriku 82-vjeçar, patrioti i shquar shkodran dhe njeriu që solli të parën shtypshkronjë në qytetin e Shkodrës, për të përhapur gjuhën shqipe nën represionin e Turqisë. Si do të dënohej me burg nga turqit, për botimin e fletores së parë politike, “Koha”, e si do të mbërrinte deri në moshën 82-vjeçare për t’u përballur edhe me regjimin e egër komunist. Fundi tragjik i një mendimtari të shquar që dha shpirt në moshën 87-vjeçare në burgjet komuniste.

71 vjet më parë, më 16 janar 1951, ndërroi jetë në burgun e Burrelit, kleriku i famshëm i Shkodrës, Dom Ndoc Nikaj. Ishte një ndër priftërinjtë katolikë të Shkodrës i shenjësuar nga regjimi komunist si një ndër personalitetet më të rëndësishme që u shpall armik i popullit.

Dom Ndoc Nikaj, shihej si një personalitet më me ndikim në Shkodër e Shqipëri, edhe për faktin se ishte romancier i parë shqiptar. Dom Ndoc Nikaj është autor i romanit të parë shqiptar me titull “Marcja” i botuar në vitin 1899. Ishte koha kur Dom Ndoc Nikaj bashkë me Abatin Prengë Doçi dhe At Gjergj Fish-tën, themeluan shoqërinë “Bashkimi”.

Pak ditë pas kryengritjes së Postribës, Dom Ndoc Nikaj do të arrestohej ndër qindra të tjerë intelektualë që u akuzuan si drejtues të kësaj lëvizjeje.

Dom Ndoc Nikaj, ishte 82 vjeç, kur e arrestuan, i vendosën prangat dhe e detyruan të ngjitej mbi një gomar. Pas shpine i ngjiten një armë të ndryshkun dhe e shëtiten nëpër rrugët e Shkodrës me qëllim për ta denigruar, u dënua me pesë vjet burg.

U dënua me pesë vjet burg

Dënimi ishte kaq i ulët në raport me të tjerë klerikë edhe për shkak të moshës së madhe/ dhe komunistët ishin të bindur se shpejt do të ndërrohte jetë në burg. Në fakt ashtu ndodhi, pas dy vitesh tortura dhe vuajtje në burgjet komuniste, Dom Ndoc Nikaj ndërroi jetë më 16 janar 1951.

Dom Ndoc Nikaj u largua brutalisht nga jeta, por la pas një pasuri të madhe për brezat. Gjatë diktaturës komuniste asnjë prej veprave të tij nuk u njohën. Por edhe pas diktaturës nuk pati ndonjë përpjekje serioze për t’i dhënë vlerën që i takon si një ndër klerikët më të shquar, një ndër patriotët më në zë që kontribuoi për rritjen e nivelit arsimor ndër brezat shqiptarë, që u përball me burgjet e Turqisë si një ndër përhapësit më të rëndësishëm të gjuhës shqipe.

Më poshtë publikohet biografia e tij sipas radio Vatikan:

Dom Ndoc Nikaj lindi në Shkodër më 15 qershor 1865, ndërsa ndërroi jetë në burgun e Shkodrës më 16 janar 1951. Ky meshtar shqiptar hyn në radhën e atyre priftërinjve e shkrimtarëve të cilët veprimtarinë meshtarake dhe shkrimin e kuptuan si mision në shërbim të Zotit e të popullit shqiptar, duke mbështetur idenë kombëtare.



Dom Ndoc Nikaj qe shkrimtar dhe punëtor i palodhshëm, njeri i zellshëm, i cili për mëse 50 vite me radhë punoi, duke mos lëshuar penën prej dorës për të lëvruar gjuhën shqipe dhe për të ringjallur te populli idenë kombëtare, për të përforcuar identitetin etnik e shpirtëror. Si i tillë, dha kontribut me rëndësi të jashtëzakonshme për historinë e kulturës shqiptare, edhe sa i përket krijimtarisë së tij të madhe e poliedrike e sidomos duke pasur parasysh kohën kur dom Ndoc Nikaj punoi, kohë kur gjuha shqipe ishte rreptësisht e ndaluar nga ana e qeverisë turke.

Veprimtarinë letrare e fillon kur ishte ende nxënës, në seminarin Papnor në Shkodër, ku po përgatitej për meshtari. Librin e parë e botoi në vitin 1888, i cili mban titullin “Vakinat e Kishës”, vepër e cila u botua në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s në Romë.

Dom Ndoc Nikaj, në këtë vepër pati dy qëllime të larta: të njihet sa më mirë historia e Kishës e populli të ketë njohuri mbi Kishën dhe krishterimin dhe e dyta të nxisë e ringjallë te populli shqiptar dëshirën e shijen për lexim në gjuhën shqipe.

Një vit më vonë (1889) boton romanin “Marcja”, i cili së shpejti u përhap pothuaj në të gjitha familjet e Shkodrës e ato shqiptare.

Abati i Mirditës, Imzot Prengë Doçi, një ditë bashkë me disa bashkëpunëtorë shkon në Shkrel, ku Dom Ndoci ishte famullitar. Bashkë me Dom Ndocin vendosin të formojnë një shoqëri, që do të kishte për qëllim përhapjen e idesë kombëtare dhe çlirimin e tokave shqiptare nga sundimi otoman. Kjo shoqëri thirrej “Lid-

hja e Mshehtë”.

Lidhja u përhap sidomos, duke iu falënderuar punës së palodhshme të Dom Ndoc Nikajt dhe më vonë përgatiti kryengritjen kundër sundimit otoman. Dom Ndoci qe transferuar prej Shkrelit në Dajç të Bregut të Bunës, ideja për kryengritjen kundër qeverisë turke vinte gjithnjë duke u pjekur, kur dhe pas përgatitjeve të duhura ajo plasi më 25 mars 1910 dhe zgjati deri më 1912 me fitimin e pavarësisë. Prifti shqiptar dom Ndoc Nikaj qe ai që kryengritjen e ndihmoi në çdo mënyrë, madje ai ishte frymëzuesi i saj.

Kur imzot Prengë Doçi përpiloi programin për formimin e shoqërisë letrare “Bashkimi” (1899) Dom Ndoci qe punëtori më i zellshëm dhe puna e ve-

primtaria e madhe e këtij krijuesi bëri që shoqëria të përhapej dhe të fitonte rëndësi të madhe. Më 1909 solli në Shkodër një shtypshkronjë në të cilën do të botoheshin fletore dhe libra në gjuhën shqipe.

Kështu më 1910, boton një ndër të parat fletore politike në Shqipëri. Kjo fletore qe botuar me emra të ndryshëm: numri i parë u quajt “Koha”. Ky titull i bie qeverisë osmane në sy, prandaj e detyroi Dom Ndocin t’ia ndryshonte titullin duke u quajtur “Bashkimi”. Pastaj “Besa Shqiptare”, “Zani i Shkodrës”, sipas kushteve të politikës së brendshme që ekzistonin asokohe në Shqipëri. Kjo fletore u botua në vitin 1921.

Në të pati artikuj plot guxim, me frymë kombëtare, për çka edhe Dom Ndoci qe dënuar me burgime, goditje të rënda, kërcënime e të tjera. Më 1897. Faik Konica fillon botimin e përkohshëm “Albania”, në këtë revistë, dom Ndoc Nikaj merr pjesë pothuaj rregullisht me artikuj me përmbajtje politike, shoqërore dhe atdhetare.

Këtu kishte pseudonimin “Nakdomonici” ku Atë Gjergj Fishta, në poezinë satirike “Nakdomonicipedija”, “përqesh” përpjekjet fisnike dhe atdhetare të këtij prifti të madh shqiptar. Dom Ndoc Nikaj punoi pa u lodhur edhe për ta njohur Evropën me çështjen e lirisë së tokave shqiptare për këtë qëllim mbante kontakte të rregullta me të gjitha shoqëritë shqiptare të krijuara nëpër qendra të Evropës. Dom Ndoc Nikaj vdiq në burgun e Shkodrës më 16 janar 1951

**Krijimtaria letrare**

Krijimtaria letrare e këtij shkrimtari

përfshin më se 30 vepra me përmbajtje të ndryshme. Elementi kryesor i të gjitha veprave pothuaj është i marrë nga jeta shqiptare, përshkruhen traditat e lashta dhe fisnike të shqiptarëve, bëhet fjalë për historinë e kombit, subjektet e tija janë të gjitha nga jeta e njerëzve tanë. Vepra më e rëndësishme është “Historia e Shqypnis”, vepër me 414 faqe, botuar në Bruksel më 1902.

“Përshkrimet e luftimeve të Shqyptarëve kundra Turkut, nën kryesin e fatosit Gjergj Kastrioti, deri në ramjen e Shkodrës në vjetin 1478 janë të gjalla e të shkrueme me një entuziazëm kombtar, prej të cilit shihet zemra e ndezun e shkrimtarit për fisin e vet”. (Shkrimtarët Shqiptarë, Tiranë, pjesa II, fq. 93.) Bashkë me Dom Kolecin, i cili është autor kryesor i fjalorit të njohur “Bashkimi” (1908), Dom Ndoc Nikaj punoi në përmbledhjen e fjalëve dhe të thesarit popullor nëpër famullina kishtare ku veproi si prift famullitar.

**Ja disa nga veprat e botuara prej autorit në fjalë:**

“Vakinat e Kishës” (1888), “Marcja e Turkis” (1902), “Historija e Turkis” (1902), “Bleta ndër lule të Parrizit” (1907). Fletorja “Koha”, Bashkimi, “Besa Shqiptare” e të tjera (1910 – 1921), “Kalendari me ditime gjithfarësh” (1910).

“Ditime të natyrshme” (1912), “Bleta e re” (1912), “Shkodra e rrethue” (Pjesa I, 1913), “Shkodra e rrethue” (Pjesa II, 1913). “Abetari i vogël për Msojtore” (1914), “Të ndollmet e Kishës” (1914 – botim i dytë), “Abetari i madh” (1914), “Libri i Blertë i Italis” (1915), “Kndime të Para” (1915).

“Ditime të Natyrshme të unjishme” (1915), “Tivari i marrun” (1915), “Bisedime Shqyp – tedeshk” (1915), “Abetari” (dorë e dytë 1916), “Përmbledhje e historis së Shqypnis për shkolla” (1917), “Bukurusha” – roman historik (1918). “Ulqini i marrun” – roman historik (1918), “Burbuqja” – roman historik (1920). “Motra për vllan” (1924), “Kalendari”, “Shqyptari” (1906, 1914, 1915) e të tjera. I mbeten të pabotuara edhe shumë dorëshkrime, ndër të cilat janë edhe shtatë romane, katër historik të vendit dhe tre në përkthim të lirë. Këta janë: “Lulja e Veshkun”, “Dashuni e Mshehtë”, “Për mik”, “Ç’pat thanë gjyshja”, “Han Islandi”, “Nji Testament”, “Te Shpella e Murosun”.

Dom Ndoc Nikaj qe vërtet një apostull i kulturës shqiptare, apostull dhe luftëtar i palodhshëm e i patrembur i idesë kombëtare. Tërë jetën e vet e shkriu në shërbim të ngritjes shpirtërore dhe kulturore të popullit të vet shqiptar. Puna e palodhshme e këtij shkrimtari duhet çmuar edhe më tepër kur dihet se tërë jetën, talentin dhe pasurinë e shkruar në botimin dhe përhapjen e librave të kulturës shqiptare.

**Lulash Brigja**

# Kadare: Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e Martin Camajt, ...

Kadare: Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e Martin Camajt, e prisja me padurim këtë takim

I. K. – Kam pasur fatin ta takoj për herë të parë Martin Camajn, në tetor të vitit 1981, në Frankfurt. Pas mbarimit të një konference shtypi, m'u afrua një burrë i pashëm, i cili, pasi më foli shqip, tha emrin e vet: Martin Camaj. E njihja, pa dyshim, nëpërmjet revistës "Shejzat" të Koliqit dhe atij iu bë qejfi që ia thashë këtë. Biseduam një copë herë në këmbë, midis zhurmimit të zakonshëm të një mjedisi të tillë. Pas vendosjes sime në Paris, një mik i përbashkët gjerman, Werner Daum, që kishte qenë diplomat në Tiranë, më solli të falat e Martin Camajt, si dhe dëshirën e tij për t'u takuar përsëri, në kushte fare të tjera tani. Për fat, sapo kisha lexuar dy novelat e tij të gjata "Rrunggajat e marsit" dhe "Pishtarët e natës", të cilat më kishin pëlqyer mjaft dhe Werner Daum më tha se ishte i lumtur t'ia njoftonte këtë gjë Camajt, baslikë me kënaqësinë time për t'iu përgjigjur ftesës së tij. E lamë takimin pas disa javësh, ngaqë do të ndodhesha në Muni, ku ai banonte, në një forum ndërkombëtar shkrimtarësh. Isha i ftuar për drekë në shtëpinë e tij bashkë me Daum-in. E prisja me padurim këtë takim, kur vetëm disa ditë përpara tij, erdhi lajmi i pikëllueshëm se Martin Camaj nuk ishte më i kësaj bote.

Është një nga shkrimtarët më të mirë të kombit shqiptar, me po atë vlerë në prozë sikurse në poezi, dy hapësira të mëdha, me të cilat ai u përpoq të zëvendësonte atdheun e munguar. Ishte po aq i fisëm në veprën e tij, sa edhe në vizionin për raportet njerëzore brenda familjes së shkrimtarëve. Këto të fundit, për fat të keq, vazhdojnë të jenë kaq munguese në jetën tonë.

Kadare, intervistë me "Hylli i Dritës".

Ismail Kadare: Martin Camaj, shkrimtar i lartësive

1. Ndjesia e parë që provon lexuesi kur hyn në botën letrare të Martin Camajt është ajo e lartësisë. Pa përjashtuar përfundimisht eufemik të shprehjes, atë që ka lidhje me gjithë shkrimtarët e mëdhenj të një letërsie, të Camaj shprehja merr një kuptim të mirëfilltë. Në shumicën e veprave të tij, në mjediset e përshkuara, në klimën e tyre, të personazhet, ajri, madje dehjet e shëndetshme apo të turbullta që vijnë prej tij, janë ato të alpeve.

Sipas Ernest Koliqit, adhures e njëherësh mentor i shkrimtarit, ky luks gjeografik lidhet me zanafillën e shkrimtarit. Lartësitë e bjeshkëve, më saktë Dukagjini, ku ai kishte lindur, kishin gjetur, më në fund, të biri i tyre, mjetin e vet shprehës.

Është një mendim i fisëm, nga ata që sa ç'kuptohen me lehtësi, aq edhe kanë nevojë për plotësim. Është e vërtetë se visoret dhe klima në veprën e Camajt të kujtojnë shpesh ato të vendeve veriore, madje tepër të skajshme, si Islanda, por



ato afrohen çuditërisht me klimën e teatrit grek, nëpërmjet të njëjtit fill të padukshëm që, siç e ka vënë re francezi Jean-Pierre Faye, kultura parake shqiptare përketej me antikitetin.

Rrugëtimet e brendshme të ndjeshmërisë artistike mbeten shpesh të pazbuluara prej nesh. Por kjo nuk pengon që në një tjetër hartë ato të kryqëzohen, ashtu siç ndodh me sagat islandeze, doket e vjetra ballkanase dhe artin antik.

Ka gjasë që më shumë se te këto, të vetmia e shkrimtarit të gjendet shkaku i thellë i këtij mënjanimi. Martin Camaj ka qenë, pa dyshim, shkrimtari më i vetmuar shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Duke i strehuar ngjarjet dhe personazhet e veta në një lartësi, që iu siguronte pavarësinë, ka kujtuar ndoshta se do ta mbronte artin e tij prej ndikimit të krahurës shqiptare, asaj së cilës kujtonte se i kishte lënë lamtumirën. I larguar tepër i ri nga atdheu, i cili çdo ditë e më tepër bëhej i huaj për të, për shkak të komunizmit, ka kujtuar se atë ç'ka humbur e ka gjetur disi në Kosovë, por ky nuk mund të ishte veçse një iluzion. Ka ndërruar truall përsëri, madje e ka lënë Gadishullin dramatik të Ballkanit, për një tjetër gadishull, më pak të tillë, atë të Apenineve, gjersa edhe prej andej është larguar përsëri. Po të kishte qenë muzikant ose piktor, më lehtë ndoshta do ta kishte shkëputjen, por arti i tij lidhej me gjuhën shqipe, atë varg të rëndë, të cilën as mundte e ndoshta as donte ta ndërronte dot. Te viset e arbëreshëve, ku, ashtu si Koliqi, shkonte shpesh, gjente vërtet një spikamë të botës shqiptare, por kishte gjasë që, ndonëse e pabezdisshme prej doktrinës, ajo spikamë e zbehtë, më shumë se zëvendësuese, ishte thjesht një trishtim. E ka kuptuar se përderisa poeti Zef Skiroi, ndonëse i lindur në këto vise, i kishte quajtur megjithatë "te dheu i huaj", aq më tepër do të ishin të tilla për të.

Një tjetër Zef, ai i Serembes, një shekull e ca më parë, e kishte shpjeguar të fshehtë:

Arbëria që prapa detit na kujton! Se në të huaj jemi te ky dhé.

Ishte gjithmonë ajo, Shqipëria, që në epokë të ndryshme rrezatonte të njëjtin trazim.

I vendosur më në fund në Lenggries të Bavarisë, në këmbë të alpeve gjermanike, që i kujtonin bjeshkët e Dukagjinit, e ka ndier se ato, në fund të fundit, nuk ishin veçse pamje. E ka ndier përfundimisht se ashtu si Filoktetin antik, me plagosjen e tij të pashërueshme, ai gjithashtu nuk do ta kapërcente dot mungesën e atdheut. Dhe atëherë, duke e parë se nuk i largohej dot më, ka bërë atë, për të cilën me siguri ka kujtuar se s'do të ndodhte kurrë: të dëgjonte lajme që vinin andej, pikërisht prej krahurës, së cilës i ishte larguar me aq ngulm. Të dëgjonte ç'ndodhte me atë popull, me zhurmat e tij, me kambanat që po heshtnin, me burrat që kishin ulur kryet, me gratë e hijshme, së fundi me gjuhën shqipe dhe me shkrimtarët dhe fatin e tyre ziptot.

Një qerthull, nga ata që duket se krijohen prej harmonive të epërme, po mbyllet, më në fund, për të sqaruar raportet e ndërlikuara të shkrimtarit me lirinë dhe me vendin e vet. Liria dhe Shqipëria ishin të ndara. Së bashku ngjanin ende të pamundura.

Martin Camaj, ashtu siç iu qëllon rrallëherë shkrimtarëve, u rrek të kapërcejë pikërisht të pamundurën. Ishte ky epilog që, në trajtë testamentare, u shpreh në fjalët e tij, drejtuar gjithë shqiptarëve, e natyrisht kolegëve të tij, pak kohë përpara se t'i linte lamtumirën kësaj bote: "Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijtë".

2. Letërsia shqipe është krahasuar disa herë me një ngrehinë të rreptë e të ftohtë, gjysmë kështjellë, gjysmë manastir. Fillimet e saj si letërsi murgjish, e kanë nxitur ndoshta një përfundim të tillë.

E paktë, e tkurrur tragjikisht, për shkaqe dhe rrethana që dihen, me një ndalim të gjatë shumëshekullor, me një periudhë dygjuhëshe, latine dhe shqipe, me alfabet të padashur, madje të demonizuar në ceremoni zyrtare fqinjësh, ka mbërritur në shekullin e njëzetë, ku, në kundërshtim me shpresën, e ka pritur një zezonë e re: censura dhe vetëcensura, fajtoreshë për të cilat nuk ishte askush tjetër veç vetë Shqipërisë.

Ndonëse e tillë, e ngushtë, përherë e pamjaftueshme, spartiate e pa madhështi

të jashtme, si gjithë vlerat shpirtërore të krijuara përmes vështirësish, e rrezatonte megjithatë një hije të rëndë. Ndërkaq, për një paradoks të madh, në vend që të ishte mikpritëse ndaj shkrimtarëve që do të plotësonin mungesat e saj, bënte të kundërtën. Portat e saj rrinin më shumë mbyllur se hapur. Prej tyre ishin nxjerrë përdhunshëm personazhe të mëdha, ikja e të cilave bënte që të ngjanin edhe më të zbrazëta hajtet dhe qelat e saj.

Përpara këtyre portave u gjend një ditë Martin Camaj. Nuk ishte i nxjerrë jashtë mureve, si Fishta, Konica, Koliqi, por kjo nuk e bënte më pak të ndërlikuar problemin e tij. Kishte qenë thjesht nënshtetas i atij vendi që quhej Shqipëri, por asnjëherë brenda kullës letrare. Ka gjasë që për një kohë të gjatë, në nënvetëdijen e tij shestohej e paarritshmja: të bënte pjesë një ditë në atë fis apo në atë urdhër trillan.

Brenda kullës, përveç hijeve të mëdha, ishin shkrimtarë të gjallë, të ngjashëm me ta, por të padashur, si Lasgush Poradeci ose Mitrush Kuteli. Siç ishin të pakuptueshëm për epokën brenda së cilës u gjendën, ashtu do të ishin më pas, kur epoka të ndërrohej. Studiuesit do ta kishin më të lehtë të pohonin se, meqenëse në një epokë të tillë mizore nuk mund të krijohej letërsi, ata e kishin braktisur krijimin letrar. Ndërkaq, pikërisht në kohën e vështirë ishin krijuar disa nga perlat më të çmuara të të gjitha epokave, si vjershat "Gremina" dhe "Flaka" të Poradecit ose "E madhe është gjëma e mëkatit" e Kutelit e ndoshta të tjera vlera, që do të zbuloheshin më pas. Pyetje të shumta do të lindnin: ç'do të bëhej me këto perla? Do të mohoheshin, ngaqë bezdisnin klishtë dhe mendjet e ngushta, apo mashtroreshëm do të kalonin në tjetër kohë?

Edhe më të vështira do të ishin pyetjet për aradhen e shkrimtarëve që kishin lindur ose ishin rritur në epokën që quhej e gabuar. Për shkak të saj, e pas rrëzimit të saj, ata do të quheshin gjithashtu të gabuar e do të binin bashkë me epokën, apo fati i tyre do të vendosej pas ligjesh të tjera, e nga një tjetër verdikt?

Martin Camaj nuk i lejoi vetes asnjëherë që, duke përfutur prej lirisë që i jepte mërgimi të shkruante kundër sivëllezërve të tij në Shqipëri. Ishte e vërtetë se në kohën që ai kujtohej e bëhej merak për ta, ata nuk u kujtuan kurrë për të, por kjo nuk e shtyu asnjëherë t'u mbante mëri për shpërfilljen apo harresën e tyre të gjatë. Ishte i ndjeshëm për gjendjen e tyre, për optimizmin e rremë e për ankthin e fshehur me kujdes midis festës po aq të rreme.

Në vetmi, rrallëherë i kuptuar nga njerëzit, Camaj vazhdonte veprën e tij, duke u përpjekur të ruante dritësimin e saj alpin, qoftë në poezitë, qoftë në prozën e tij. Ishte pakti i tij i pandryshueshëm me artin, me lartësitë e bjeshkëve nga kishte dalë, e ku një ditë shpresonte se do të kthehej.

S'due me qenë si moti i lig, kumtonte

në një nga vjershat, duke shpallur kështu kthjelltësinë e fisme mbi pasionet politike, e sidomos mbi mllefet, pa të cilat ishte vështirë të përfitohej bota shqiptare. “Poezia shihet si formulë për ngadhënjimin e tragjikës”, shkruante për veprën e tij poetike studiuesja gjermane E. Glaser. Ai vetë do të sqaronte se “prej letërsisë kam pasë gjithçka, edhe vullnetin për të jetue”. Që nga përmbledhja e parë “Një fyell në male” e vitit 1953, në Prishtinë, e gjer te “Palimpsesti”, i botuar më 1991 në Munihi e Nju-Jork, pak kohë përpara vdekjes, shtrihen dyzet vite krijimtarie të pandërprerë poetike. Poezisë së tij, ndonëse e një drejtimi që gabimisht dukej i huaj në letrat shqipe, modernizmit evropian, kryesisht hermetizmit, përkundër paragjykimëve shkollareske, i shkon natyrshëm kostumi shqiptar. Arti i madh është njëherësh i kohës e i gjithëkohës. “Këngët e Milosaos” e De Radës, e cila disa vite më pas do të mbushë dy shekuj jetë, na tingëllon po aq e freskët e moderne sot, sa në vitet kur u shkrua.

Në art asgjë e epërme nuk është e përjashtuar, e aq më pak përjashtuese. Kështu janë poezitë e Camajt, romani i shkurtër “Djella”, me shoqërimin poetik, që si një pasqyrë iu hap udhë rreshtave të prozës, veprat e tjera, si “Dranja” dhe “Karpa”, ku në të parën u rrek të sendërgjojë fatalitetin a mallkimin, me fjalë të tjera, të rrokë të parokshmen e të shprehë të pashprehshmen, tundim jo i rrallë i shkrimtarëve. Ndërkohë në të dytën përipiqet të shkojë edhe më larg, i ndjellë prej

një magjistareje lojcake, gjuhës shqipe, prej përdorimit të së cilës, siç thotë vetë: “e kam ndie veten shpesh virtuoz, d.m.th, jam në gjendje të thom shqip gjithçka due!”.

E po kështu vijnë veprat e tjera, si romani “Rrathët”, dy dramet e përkora, për të mbërritur te novelat e gjata, “Pishtarët e natës” dhe “Rrunggajat në mars”, ato “fletë të lume” në letrat shqipe, po të përdornim shprehjen e Koliqit, e që ndoshta përbëjnë majën më të lartë të artit të tij.

3. Në tetorin e vitit 1981, një nga stinët më të zymta të tiranisë shqiptare, rrethanat e sollën të takoj Martin Camajn. Isha i ftuar në Panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt, kur, në mbarim të një konference shtypi, gjatë së cilës iu isha përgjigjur pyetjeve jo të lehta të gazetarëve, m’u afrua një burrë i gjatë e i hijshëm që, me njëfarë mëdyshjeje, më foli shqip: quhem Martin Camaj, a mund t’ju flas? E kisha dëgjuar emrin e tij, madje diçka kisha lexuar prej tij në revistën “Shejzat” të Koliqit, që botohej në Romë e gjendej me vështirësi në Tiranë. I thashë, natyrisht, që mund të flisim dhe ai shtoi se kishte ardhur enkas nga Munihi për të më dëgjuar.

Një mik i tij shqiptar që e shoqëronte, ka përshkruar vite më pas në shtypin e diasporës ato pak minuta të takimit, kryesisht mëdyshjen dhe shqetësimin e tij se mos, duke më folur, më dëmtonte. Ishim aty, në atë sallë të zhurmshme, shkrimtarë të të njëjtin vend e të së njëjtës

gjuhë, por të largët si dy qenie, më saktë, dy fantazma të planetëve të ndryshëm. Ishim dy Filoktetë, gjithmonë me të njëjtën plagosje të njohur të pashërueshme, njëri që e kishte atdheun, por jo lirinë, tjetri, me liri, por pa atdhe.

Folëm diçka, në vështrim të parë të rëndomtë, por që, me siguri, nuk kishte të bënte me atë çka do të duhej të flisnim. Rreth dhjetë vite më pas, Werner Daum, intelektual dhe diplomat i shkëlqyer gjerman, mik i përbashkët i imi dhe i tij, personazh i dorës së parë në ngjarjet dramatike të Tiranës 1990, më ka takuar në Paris, për të më sjellë ndër të tjera përshëndetje nga Martin Camaj. Me ndërmjetësinë e diplomatit u vendos midis nesh një shkëmbim i përkorë mesazhesh, madje u caktua dhe një takim në Munihi, ku do të udhëtoja dy muaj më pas, në mars të vitit 1992, në një forum ndërkombëtar shkrimtarësh.

Ky takim nuk ndodhi kurrë, për shkak të ikjes së tij të parakohshme, pikërisht në muajin mars të atij viti. S’më mbetej veçse, me ndihmën e shoqërueses sime, gazetares së “Frankfurter Rundschau”, Verena Nolte, që e njihte dhe e çmonte, të kërkoja varrezën ku pushonte, për të vënë një tufë lulesh sipër tij.

Nëpërmjet Werner Daum-it, kisha aritur t’i tejcoj disa mendime për veprën e tij. Por ato ishin tepër të pakta në krahasim me atë çka do të duhej të thuhej. Një pjesë e tyre janë shprehur në këtë hyrje të botimit të veprave të tij të plota, tetëmbëdhjetë vite më pas, e gjithmonë janë

pak. Të tjerat e kanë kohën e tyre përpara, atëherë kur vepra e shkrimtarit do të ketë qasjen e saj të plotë të lexuesit, atje ku nis një jetë tjetër e artit të letrave, ajo që përtëritet prore, në pafundësi.

Epokat dhe popujt zakonisht nuk bëjnë gabime në vlerësimin e artit të madh. Edhe kur gabimet ndodhin, nuk janë veçse të përkohshme. Gjithmonë vjen ora kur të vonuarit mbërrin dhe të munguarit shfaqen. Kështu kanë për të zënë vendet e tyre Anton Pashku i Kosovës dhe Zef Zorba i heshtur, dhe të tjerë ndoshta, të cilët, prej rastit ose rrethanave, janë penguar diku.

Tiranitë, krahas nervozizmit dhe stuhive kalimtare, janë përpjekur të krijojnë portat e rreme e të gabuara. Në ngrehinën e përkorë të letrave shqipe, atje ku është duke zënë vendin e vet Martin Camaj, ashtu si në çdo panteon, hyhet vetëm prej një porte, asaj të madhes. E ajo portë, siç e tregon emri, nuk njeh veçse arsytet e mëdha.

Siç është thënë dikur, De Rada i paharrueshëm, në një përshkrim të natës së pashkëve, ka rrëfyer për “engjëjt që e bëjnë veç gostinë e tyre”. Në tryezën e epërme, ku kanë zënë vend krenajat e letërsisë, nuk ngjiten zhurmat e vogla e as afrohen profilet e rëndomta. Atje ka përherë mirëkuptim e harmoni, ndaj e kremtja vazhdon përherë dhe ndriçimi i shandanëve nuk sos.

(Marrë nga Vëllimi i Parë i veprave të M. Camaj, Onufri, Tiranë, Prill 2010)

## TEK LINE LEKJA ISHIN MISHËRUAR CILËSITË MË FISNIKE TË NJË GRUAJE MALËSORE TË KOHËS SË SAJ

(Simjet kumbara yt Balë Marku ka me të thirre ndrikulli në lumnimin e përnasit)

Jetë, o jetë gjithsekënd solle në djepin tënd e more pa harruar asnjë.

Nga një tërvete ndrikullash shembullore që kam, Line Lekja ishte më e veçanta, sepse qe më e moçmja dhe e vetmja ndrikull e Balë Markut, i cili jetonte akoma. Mirësisht, në moshën 85 vjeçare mbylli sytë për gjithmonë dhe u be “nuse” në jetën e pasosur e ndriçuar nga një vegim drite e pa pruar.

Ndrikull Lina pardje iku, por me ringjalli jo pak kujtime të hershme, duke mu përshfaqur tamam si atëherë 50 e kusur vite më pare, kur vinte veshur hijshëm, pastër, thjeshtë me kotull korbe pala, pala, opinga safjani të kuqe, çorape të thurur me shtiza e shputa të qëndisura plot shkrola, me krahol cohe e shami mëndafshi. Në krah mbante traste të leshte, që varej deri tek brezi punuar në katoliq stiluar me ngjyrat më të ndezura. E prisnim me gëzim ardhjen e saj se ishte e dashur, e ëmbël, por edhe na binte plot dhurata, që në atë kohë ishin mollë, e ndaluar Dada gjyshja ime (Katrinë Prekja) thoshte: Nuk ka shoqe strajca e Linë Lekes! Edhe kur ishte e ndaluar vinte rregullisht çdo mot në të ashtu quajtur të thirrur. Aty bëheshin edhe me Sose Prelen e Palajve (një grua shumë fisnike e pashme dhe dhimshur). Sosen e linte gjithmonë në krye të vendit se, ishte më e moshuar.



Nga sa kane regjistruar radarët e mije kureshtare edhe ato ndiheshin shumë mirë, qëndronin më lirshëm se gjithkund tjetër. Ndihmonte gjyshen dhe nene për ndonjë punë dore, ndërsa më përqafohte e më uratonte shumë. Pinte nga një gotë raki pa i bere kurrë dy. Unë u afroja venë dhe i siguroja se nuk ju bën keq se, ashte venë Pepsujmash. Ani i thoshte Lina, Soses edhe po na bani keq jemi te kumbara, por jo nuk bindej ta shteronte gotën.

Lines i thërrisnin ndrikull edhe kushritë e mije. As një here nuk shkante pa ba

edhe një vizite te Dede Lushi dhe Katrine Tomja. Lina Lekja doli nga shtëpia e të kënduarit Nikë Vukasnit (bash e mbesa) dhe erdhi në një dere të kamur, të mirëpërmendur dhe nga më tërvestaret e Shoshit.

Të bej ketë shkrim më dha shtypte edhe një fjalë e ish nxënësit tim, Milan Çun Fusha, kur me plot sinqeritet më tha:

- Grua moshatare më të mirë, se Linë Lekja nuk kishte katundi i Ndreajve. Kurrë nuk ju ndie zani, kurrë nuk beri fjalë me askënd, kurrë nuk endi fjalë as nxiti sherre me askënd.

Tek Line Lekja ishin mishëruar cilësitë më fisnike të një gruaje malësore të kohës së saj. Lima mishëronte virtytet më të çmuara të një nene shembullore, të një blete punëtore, të një stanice pastërtore, të një Zoje shtëpie të zgjuar, zemër madhe, që dinte me mate e me pre.

Linë Lekja ishte bujareshe racë, ajo sakrifikoje gjumin e natës, pushimin e ditës, ndau kafshatën e gojës, zbrazti vegshin e fëmijëve me pritë e përcillte të njohur e të pa njohur, që bujtën në derën ndertare të Lulash Pjetres e Mirash Mehillit. Nuk ishte grua që piculohej me lule-lajle, por gjithmonë e veshur pastër thjeshte e bukur. Fëmijët e saj ishin jo vetëm më mësimdashës, por dhe më të pastrit e mirëveshurit veç prej duarve punëtore të Lines. Shtëpisë shihi obor-

rin dhe të tregon se si është brenda dhe çfarë zoje shpie ka. Së paku në ditën e lamtumirës së fundit duhet shkundemi nga egoizmat e vegjël. Në kohën kur në Shosh qëndronte e ulur këmbëkryq skamja, dhe e përditshme një mungese e pa justifikuar higjienë. Shtëpia e Pjeter Lulashit, shkëlqente nga pastërtia, muret e bardha bore, dyshemeja e lare, rrobat që u vinte arma, fije ose sapun dhe kjo nga duart e Lines e ndihmuar më vonë edhe nga vajzat, që i ngjanë.

Ndihem mire kure sot pas 50 vitesh, shumë ish quadro nga jugu, Shqipëria mesit dhe veri lindja shprehen: -Te Pjeter Lulashi kemi gjetur, ngrohtësi, bujari, pastërti dhe rregull. Larg qoftë sikur të kishte qene një Linë tjetër nuk do flisnim kështu. (Besa fort më lehte ishte të prisje një tërvete malësore se dy quadro të ardhur nga lart). Vetëm Zoti e dinë se sa kanë vuajtë, pritë e përcjellë Lina dhe Pjetri nder ato vite të vështira, duke i bërë ndere gjithë Shoshit.

Ne, që jemi dëshmitare pse nuk e themi, ketë fakt sa themi se shtëpia Pjeter Lulashit ishte shtëpi partie. Jo more jo, se mbi të gjitha ishte shtëpi ndere dhe bujari shembullore.

Ndrikull bujarie, rrugën për në Parajse ja shtrove vetes me thjeshtësi, dashuri, bujari e njerëzi. Le pas dhjete fëmijë emër mirë, shëmbëlltyre e mirësisë sate!

Pushofsh në paqe e lumin me Zotin! Kur të vinë muaj i të thirrurave sivjet kumbara yt, Balë Marku ka me të thirre ndrikull, në lumnimin e përnasit.

Prele Milani

# TOPLANA E VOGËL NË NUMËR E HISTORI T' MADHE

Dukagjini në tërësi,  
Ka histori me lavdi.  
O Toplanë, burrneshë kreshnike,  
Lum për trimat që ti rrite,  
Bujarinë, shumë fisnike,  
Besë e nderë e traditë,  
T'a dhanë burrat me meritë,  
Mendjen trima, flakë e zjarrë,  
E fortë për luftë e urtë për fjalë,  
Me banore burrnor, me zemër të madhe,  
Bane ëmën në ato male,  
Dukagjinit kurrë s'ju ndave,  
Vlerë e jetë, në luftë e kuvend,  
N 'altar të historisë zunë vend,  
Bashkë luftuat e jetuat,  
Trojet ruajte, e nuk i lshuat,  
Asht vlla me Gashë e Shllak,  
Kurrë pushka s'u bani çark,  
Besë e bujari i ke në gjak,  
Historia n 'shekuj i ruan,  
Prej n 'qafë të Agrit e n 'qafë Mgullë,  
Te Ura e mesit e n 'lumë në Merturë,  
Kurrë hasmit s'i lëshuan rrugë,  
Jeta i vendosi në provë,  
E përballuan me armë në dorë,  
Ajo ja ruajti vlerat vetit,  
S'u nënshtruan krajlit as mbretit,  
Mbetë kështjellë e qëndresës,  
Ta dhanë trimat e luftës e t 'besës.

Kur historianët e perëndimit,  
Studiuan historinë e Dukagjinit,  
E i dhanë emnin e nderimit,  
Për vlerat e luftës dhe qëndrimin,  
Për Toplanën shprehën mendim,  
E vlerësuan katund trim,  
"Toplana e vogël si popullsi",  
Por e egër për trimni,  
Kjo ishte merita jote,  
Trashëguar e ruajt në mote,  
Me Dukagjinin në pararojë,  
Nderi e lavdia e kombit tonë,  
Të vlerësoj Malësia e Dukagjinit,  
Me ty besën ai e lidhi,  
N 'luftë e kuvende gjithmonë të thirri,  
Përballuen çdo rrezik,  
I qëndrove shumë besnik,  
Ju jetuat shumë trazime,  
Herë në luftë, herë në provokime,  
Me vendosmëri batë gjajret,  
Toplana përballoi pjesën e vet,  
Kur në qafë të Mgullës shkjaq msyni,  
Në alarme gjithë Dukagjini,  
Toplana, Planit i shkoj në ndihmë,  
U caktuan burrat me razit,  
Nga dy vetë për çdo vllazni,  
U plotësue numri njëzet e dy,  
Mark Sadria me dy kushri,  
Si burrave u ka prij,  
Rrugë pa rrugë, male e shkrepë,  
Nuk e ndali hapin çeta,  
Me merri shpejt ku duel potera,  
N 'ato brigje vendosë në prita,  
Ç'po qëndron Mark Sadria,  
Flakë po i qesin pushka e alltia,  
S'pe lëshon priten për të gjallë,  
I duel shkjaq ballë për ballë,  
Ballë për ballë me oficer shkja  
Të dy bashkë vdekun kanë ra,  
Gjaku i tij shkruan lavdi,

Me germa të arta në histori,  
Do të nderohet në përjetësi.

Në vazhdimësi në histori,  
Një ngjarje tjetër me ranësi,  
Qafa e Agrit shkruan lavdi,  
Guri Murg tregoi madhështi,  
Kur Turgud Pasha me ushtri,  
N 'befasi malësinë e msyni,  
E bllokoi Mërturi e Dukagjini,  
T' pa kalueshme rrugë, male e qafa,  
Turgud Pashën e kthyen prapa,  
Aty Toplana tregoi aftësi,  
Prej n 'qafë Kunorë deri mbi lumin Dri,  
Afër katërmëdhjetë kilometër në tërësi,  
E bllokoi me burrat e fisit tij.

Një ngjarje tjetër lajmin po e jep,  
Shumë telashe Toplanës po i qet,  
Po e përballon me burrat e vet,  
Me përshkrue këtë rastësi,  
N 'mal të Stërziqes Serbi mrrini  
Rreptë Toplanan e msyni,  
Kur donë fati me të ndihmue,  
Ndodhë dy burra tuj punue,  
Atë ushtri e kanë diktue,  
Kur ata ulë me pushue,  
Këta burra trima, e me vlera  
Lulash Gjoni e Mhill Nik Deda,  
Ja nisën pushkën, e dhanë kushtrimin,  
Në alarme çuan të gjithë fisin,  
Gjëmoj Drini, mali po dridhet,  
Toplana trime nuk po lidhet,  
Zemër e mendje flakë e zjarr,  
Të fortë për luftë e të urtë për fjalë,  
Po qëndron si e ka traditë,  
Për të gjallë trojet nuk i lëshon.  
Vazhduen luftën, e banë rrethimin,  
Ai Smajl Preka piskamë thirri,  
Ku je nisë o Veshoviqi,  
Mendo mirë çka ka me të gjetë,  
Me lanë ushtrinë e me met vetë,  
Edhe kockat me t'i tretë,  
Nëpër pyje, shkrepë e prroje,  
Korba e sorra me t' ba roje,  
U tmerrue i biri i Shkinës,  
Burizan, i tha, bjeri burisë,  
Me u kthye mbrapa thuaj ushtrisë,  
Se varr nau ba toka e Shqipnisë,  
Këtu e nderuan burrat Toplanën,  
Veshoviqit i banë gjamën.

Shumë situata përballoi Dukagjini,  
Koha e Zogut, kohë trazimi,  
Kur i randë u ba sundimi,  
E popullit ju sos durimi,  
Dukagjini Shkodrën e msyni,  
Te Ura e mesit filloi luftimi,  
Por ju pengue keq marrshimi,  
Kryengritja pjesoj tradhtinë,  
Aleatët s'i shkuan në ndihmë,  
Atëherë Zogu ka urdhnuë,  
Dukagjinin me e izolue,  
Dërgoj Lumen me e masakruë,  
Toplana në këtë betejë pjesë mori,  
Prinë Martin Marashi e Lulash Sokoli,  
Lulashi në arrati, Martini në burgim,  
Dhe për litar i dhanë dënim,  
Burrat e Shoshit shpejt vepruan,  
Në ato kushte e ndihmuen,  
Dhe jetën ja shpëtuen,  
Je i ri me u damtue,  
Shko në Dukagjin me dëshmue,  
Si po desim e si kem qindruë,  
N 'litar po shkojmë tuj këndue.

Në kohë të vona një lajm doli,  
Qafa e Agrit ishte simboli,  
Kushtrim lëshoj Lulash Gjeloşi,

Thuaj Toplanës amaneti i Zotit,  
Me më ndihmue si dikur motit,  
Por s'erdh vetë as burrat e Shoshit,  
E çoj Toplanën në grykën e topit,  
Thotë në qafë të Agrit pritat me i zanë,  
Me luftue me partizan,  
U hap lajmi porsi era,  
Me msy burra ku duel potera,  
Vrapojnë burrat porsi rrejeja,  
Kush ma parë ku i pret beteja  
Ai Prel Doda e Shpend Sadria,  
Për besë e fe i vlersoi trimnia,  
Të parët aty kanë mërrri,  
Nata terr e koha me shi,  
Pa pritë e pakujtue,  
Një brigadë i ka rrethue,  
Për besë e nderë donë me qindruë,  
Por qindra plumba i kanë përshkue,  
Heroizmi nuk vdes kurrë,  
E shkruan me gjak në flamurë.

Si në lashtësi, e në kohë të vona,  
Rritën trima trojet toja,  
Shumë herë i vlerësoj vendi,  
Si te lufta e te kuvendi,  
Si Gjur Vata e Koc Prendi,  
Vocerr Meta e Lulash Pali,  
Prijsa n' derë i pati vatani,  
Rrustem Lulashi e Pal Uka,  
I njohu tërvesa, besa e pushka,  
Zef Gjoka e Nosh Kola,  
Në çdo situat i njofti koha,  
E Coc Lulashin në veçanti,  
Dy vjet luftë me nëmceli,  
I vranë tre vllazën e axhën e tij,  
Shiqer Nduen e Zef Kolën kushri,  
Kishte manxerre me dylbi,  
Muar malin në arrati,  
Smujti krajli në dorë me e shti,  
Ra në prita disa herë,  
I përballoj e duel me nderë,  
Thonë ka vra 18 asqer.

Ti Toplanë burrnisht qëndrove,  
U nderove e u respektove,  
More pjesë në shumë kuvende madhore,  
N 'Fan të Mirditës në parinë krahinore,  
Ligjërue qeverinë provizore,  
Njëzetepesë prijësa firmosën vendimin,  
Tuj përfshi gjithë Dukagjinin,  
Të gjithë veriun e angazhoi,  
Për Toplanën firmosi Qerim Ndou,  
Dhe në Gërçë, përtej n 'kufi,  
Një kuvend më shumë ranësi,  
Toplana pati përfaqësi,  
Bal Mark Lulashi burrë dai,  
Muarën vendim me ranësi,  
Me ruajt flamurin kuq e zi,  
E luftë me ba për pavarësi,  
Mei thanë Evropës "Jemi Shqipni",  
Si të krishtënë e mysliman,  
Jemi vllazën e kemi një nanë,  
Nanë e madhe me lavdi,  
E ka emnin "Nanë Shqipni".

Toplanës gjithmonë i qeshin kullat,  
Aty lindin e rriten burrat,  
Kullat gurit, bardhë si bora,  
Skalit mjeshtër, ju lumtë dora,  
U dalluan në krahinat tona  
Ajo trashëgon emrin "Toplana e Kuqe",  
Jo me simbolin vel për nuse,  
Por e kuqe për trime lufte,  
Të mirë për shokun e mikun,  
Të rreptë e të fort për anmikun,  
Asht amanet i të parit,  
Mbajt e ruajt djalë mas djalit,  
Dikur motit i ka thanë Topjanë,  
Në kohë të vona emnin Toplanë,

Ky ndryshim ishte deformim,  
Se kishin ndryshim në kuptim,  
I pari vlerë i dyti mohim,  
S'po ka randësi i pari as i dyti,  
Toplana gjithmonë burra rriti,  
Besë e ndërrë i patën traditë,  
Përballuen çdo rrezik

Jeta solli zhvillim,  
Jo vetëm në Dukagjin,  
Marrëdhëniet pësuan ndryshim,  
U ftoh uniteti e respekti,  
E kaluemja e mori me veti,  
Kur filloj biznesi në jetën shoqnore,  
U lodh vlera e cilësia burrnore,  
Ashtu edhe tradita,  
Në Dukagjin, që në kohë të lashtë,  
Traditat i kishim bashkë,  
I ruajtëm në çdo situatë,  
Por sa u fut tregun në zhvillim,  
Respekti pjesoj ndryshim,  
Në mendim e veprim,  
Të panjoftun në Dukagjin,  
Por kohët pësuan ndryshim,  
Duel biznesi si përparësi,  
Komandon tregun për pasuri,  
U kthye burrnia në leverdi,  
Se e kanë emrin "nder e burrni",  
Në Dukagjin parim i madh,  
Traditat tona janë moral,  
Të respektueme me nderim,  
Me unitet forcë e bashkim,  
Na dhanë nder e përparim,,  
Respektin ta rruajmë me moral,  
Mos të gjykojmë i vogël apo i madh,  
Dikur në mote, në kohë të ngushtë,  
Bashkë në kuvend e në luftë,  
Tash as te tërvesa për nder e bukë,  
Po duken si në rastësi,  
Do rregulla të reja si thjeshtësi,  
Në do morte a kortezi,  
Kur lajmërojnë katundet anë për anë,  
Do të dëshiroja edhe emrin Toplanë,  
Mbasi emri i saj është në taban,  
Ruhet në arkiva deri në Vatikan,  
E kështjellën e artë të historisë,  
Shkrue me gjak në flamur të lavdisë  
Dukagjini ruan emër të madh,  
Ti ruajmë traditat me taban,  
Duke sikur po mbyllim epokën,  
Rinia po preferon botën,  
Ku po punojnë dhe po jetojnë me auto-  
ritet,  
Janë qytetnue, kane fitue respekt,  
Përparue në kulturë e shkollë,  
Nuk merren me trafike e drogë,  
Njohës të mirë të qytetimit,  
Me shumë të rinjë të Dukagjinit.  
Toplana në biznese po shkëlqejnë,  
Ndërtue me mund, djersë e vlerë,  
Me i permendë për nderim,  
Dy tre yje të katundit tim,  
Kanë ba emër, meritojnë lëvdata,  
Bal Ferosi e Tom Arra,  
Në Rragam vendosë mbi breg,  
Gjelosh Bicaj po shkëlqen,  
Pikë turistike me shumë vlerë,  
E si këta ka edhe të tjerë.

Bamë, e çka bamë, e asgja nuk bamë,  
Tokën këtu e gjetëm, këtu e lamë,  
Me mund ndërtuem jetën,  
Ajo na shpërblej mundin e djersën,  
Po largohemi e s'mund e përshëndetëm,  
Toplana ruan emnin e vet të madh,  
Me Dukagjinin në pedestal.

## \*\*\* POEZI Lulash Ara \*\*\* POEZI POEZI Lulash Ara \*\*\*

## PËR TY DUKAGJIN

Çfarë ka syri që loton  
Pse po dridhet buza ime  
Dikun larg mëndja më shkon  
Ku kalova rininë time.

Ku lumenjtë zbresin prej malit  
Fjala e burrit ku ka vlerë  
Maja e Biges, dhe e Cukalit  
E ruajnë borën dimër, verë.

Ku është bredhi, ahu e pisha  
Ku ka kroje e livadhe  
Ku ka djem të fortë si bisha  
Që vallëzojnë me shtojzavalle.

Ku malet puthën me retë  
Ku ka brigje, kodra e lugje  
Ku shqiponjat ngrejne foletë  
Ku ka vajza faqekuqe.

Ku janë rritë burra me mënd  
Ku është besa e burrëria  
Dukagjin më i bukuri vënd  
Ku s'ka njoftë kufi trimëria.

I tretur në dhe të huaj  
Larg nga ti rrugëve të mërgimit  
Por krenar para gjithkujë  
Kur them jam prej Dukagjinit.

Shetis botën pambarim  
Sytë e mi çfarë nuk shikojnë  
Por në gjumë trupin tim  
Tek ti ëndërra e bjen gjithmonë.

Dukagjin, vendlindja ime  
Të dua me shpirtë e zemër  
Je gjithmonë në mëndjen time  
Për mua je më i bukuri emër.

## DASHURIA

Dashuria është një ndjenjë  
Që lindë dhe kur se pret  
Dashuria është e bukur  
Është e ëmbel, gjithë lezet.

Dashuria të zgjatë jetën  
Të rinon, të jep freski  
Dashuria nuk njeh moshë  
Është më e bukura magji.

Dashuria, kur është e pastër  
Është si ari, që kurr nuk ndryshket  
Dashuria është si një lule

Don ujitë, përndryshe vyshket.

Dashuria e vertetë  
As nuk shitet, as nuk blehet  
Dashuria është si kristali  
Don kujdes, përndryshe thehet.

## “SIMFONIA” E NJË NATE NË FSHAT

Qetësia e natës priset për një çast  
Një ulërimë ujku vjen andej nga mali  
Një mace mjamullin lartë përmbi  
pullaz  
Dhe fillë pas sajë një hingëllimë kali.

Një dele blegërin, një qen duke lehur  
Një cjan tund zilen në qafën e ti  
Më tutje në pemë hutini i fshehur  
Nisë këngën, sa bukur, sa mrekulli!

Vazhon kjo “orkestër” të luaj  
“simfoninë”  
Dirigjente hëna, që ndriçon përmbi  
Kaq ëmbël sëbashku krijojnë  
melodinë  
Sa dhe Beethoven do ja u kishte zili.

Ylli i dritës në qiell rrezaton  
Dhe paralajmëron ardhjen e  
mëngjesit  
Papritur veshi një zë të dëgjon  
Është zëri i bukur i një këndezi.

E dua natyrën, e dua pa masë  
Livadhet me barë, malet me dëborë  
Kullat prej guri, mbuluar me rrasë  
Jam lindur e rritur në një fshat  
malorë.

Eh..ç'bukuri kishte dita edhe nata  
Te ky fshat i vogël, që kurr se harroj  
Tani kanë kaluar mbi dy dekada  
Që këtë “simfoni” më nuk e dëgjoj.

Jetoj në metropole të Europes plakë  
Mes zhurmash e britmash që kurr nuk  
pushojnë  
E malli për vendlindjen zemrën ma  
djeg flakë  
Në gjumë gjithmonë ëndërrat veç atje  
më çojnë.

## UNË - TI...DHE VALA

Mbi rëren e lagur emrin tënd shkrova  
Pas pak pashë që vala e kishte

zhdukur  
Me detin gati sa nuk u zemërova  
Dhe shkrova përsëri emrin tënd të  
bukur.

U ngrita në këmbë dhe rrija përballë  
Dhe prisja valën me shumë neveri  
Por si për çudi deti këtë rradhë  
Po rrinte i strukur, në shtratin e ti!

Fillova të qeshja me vete si i çmendur  
Lexova dhe një herë emrin me  
deshirë  
Mos vallë dhe deti nga unë ishte  
trembur  
Dhe kërkonte të ikja, dhe ta lija të  
lirë!

Mbi detë hodha vështrimin larg sikur  
shqiponja  
U ngrita dhe nisa rrugëtimin ngadalë  
Ky emër i bukur, formuar me pesë  
shkronja  
Ishte shkruar në zemër, dhe se fshinte  
asnjë valë.

## LIVADHI I FRASHNIT

Në bjeshkët e mija  
Atje në malësi  
Vetë Perendia  
Ka bërë mrekulli!

Mbushur me pyje  
E livadhe plot  
Eh...çfarë bukurie  
Të sheh syri i jot!

Burime e mriza  
Lule përmbi gurë  
Drethe e boronica  
Shijonim dikur.

Mësuesit na çonin  
Çdo vitë në shetitje  
Sikur fluturonim  
Rrugës në ngjitje.

Kur atje mbërrinim  
Uleshim rrafshit  
Na shtonte gëzimin  
Livadhi i Frashnit.

Sa lezet ka pasë  
Duke luajt mbi barë  
Kur klasa me klasë

Viheshim në garë.

Topi lartë hidhej  
Vallëzonte livadhit  
Një fërlig sillej  
Aty afer zjarrit.

Sa kënaqësi kishim  
Hallet i harronim  
Dhe të gjithë sa ishim  
Këngës ja fillonim.

Ah...ket livadh  
Sa shpesh e kujtoj  
Malli është i madh  
E s'mund ta harroj.

Kurse sot i ziu  
Në vetmi ka ngelë  
Ndoshta këmbë njeriu  
Tjetër nuk e shkelë !



## REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,  
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan  
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon  
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:

**PETRIT SOKOLI NGA FSHATI  
LEKAJ, KRAHINË E SHALËS,  
ME BANIM NË MIÇIGAN**

